



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

*Komisioni hetimor i Kuvendit “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga  
Presidenti i Republikës së Shqipërisë”*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 25.05.2021, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Alket Hyseni – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të datës 24.05.2021.
2. Debat mbi provat e administruara dhe objekti i hetimit të komisionit, si dhe caktimi i relatorëve.
3. Çështje të tjera.

**Marrin pjesë:**

Alket Hyseni, Myslim Murrizi, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Elena Xhina, Spartak Braho, Halil Jakimi, Nikolin Staka, Arlind Çaçani, Edmond Stojku dhe Eugen Bojaxhiu.

## HAPET MBLEDHJA

**Alket Hyseni**- Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e komisionit hetimor “Për shkeljet e rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”.

Sot në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbalit të datës 24.05.2021; debat mbi provat e administruara dhe objekti e hetimit të komisionit, si dhe caktimi relatorëve dhe pika e tretë, çështje të tjera, nëse ka çështje jashtë rendit të ditës. A jeni dakord me rendin e ditës? Dakord.

Fillojmë me pikën e parë. A ka dikush vërejtje apo komente për procesverbalin? Jo, nuk ka.

Kush është dakord me procesverbalin? Të gjithë dakord.

Miratohet.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës. Unë e deklaroj të hapur debatin për objektin e punës së komisionit hetimor “Për shqyrtimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”.

Dua të orientoj, këdo nga kolegët, që, mbi bazën e të gjitha provave të administruara, akteve zyrtare, pamjeve filmike, postimeve të ndryshme, sensibilitetit publik, reagimeve të komuniteteve të ndryshme dhe bindjes së brendshme të tyre, të gjykojnë mbi bazë të respektit të Kushtetutës, të respektit të ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe të jemi sa më objektivë, sa më profesionalë, përtej emocioneve, përtej, qoftë, edhe bindjeve politike dhe përkatësisë politike të secilit nga ne para momentit të anëtarësimit në këtë komision. Edhe një herë, e deklaroj të hapur debatin.

Zonja Bushka, fjala për ju.

**Klotilda Bushka** - Faleminderit, zoti kryetar!

Fillimisht më lejoni të përcaktoj edhe një herë se në çfarë faze të shqyrtimit procedural jemi. Në vijim të kalendarit të punës së planit të hetimit të këtij komisioni hetimor, sot, pasi kemi përfunduar administrimin e provave të kërkuara gjatë procesit të hetimit, jemi në fazën e diskutimit mbi provat, pasi, në kuptimin procedural, hetimi është mbyllur. Pra, ne nuk do të kërkojmë prova të tjera, apo nuk kemi nevojë për të hulumtuar ose hetuar mbi çështje të tjera, jashtë atyre që kemi hetuar dhe që lidhen me objektin e hetimit të këtij komisioni. Pra, për sa kohë e kemi konsideruar se të gjitha provat që do të ndihmonin vlerësimin tonë janë depozituar dhe janë administruar pranë komisionit, si dhe është mbyllur hetimi, është radha që ne të shqyrtojmë këto prova dhe, në harmoni dhe në përputhje me kuadrin ligjor që aplikohet në këtë

proces procedural, gjithsecili nga ne ka të drejtën e krijimit të një bindjeje të veten në lidhje me gjetjet dhe rezultatet që vijnë nga ky proces hetimor.

Jemi një komision hetimor që po hetojmë shkeljet e kryera nga Presidenti i Republikës, siç parashikohet në kërkesën e 49 kolegëve deputetë dhe në vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 45/2021, datë 07.05.2021. Për ta kujtuar edhe një herë, jo vetëm për kolegët, por edhe publikun, objekti këtij komisioni është hetimi dhe verifikimi, nëse aktet e kryetra dhe deklaratat e dhëna nga Presidenti i Republikës gjatë periudhës përpara dhen gjatë fushatës zgjedhore, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore 2021 përbejnë shkelje të rëndë të Kushtetutës; germa “b”: verifikimi i pasojave të këtyre akteve në raport me parimin e unitetit të popullit, prishjen e ekuilibrit politik, të qetësisë publike, nxitjen e urrejtjes dhe dhunës, vënien në rrezik të jetës së njerëzve, ndërhyrjen dhe intimidimin e institucioneve publike, dëmtimin e imazhit dhe reputacionit të vendit, si dhe marrëdhëniet me partnerët strategjikë të Shqipërisë; verifikimi i akteve, sjelljeve dhe qëndrimeve të caktuara të Presidentit të Republikës, në raport me rolin dhe pozitën e tij kushtetuese.

Konkretisht, duke iu referuar objektit të hetimit dhe kërkesave të parashtruara në kërkesën e 49 kolegëve tanë deputetë, pretendimet lidhen kryesisht me këto shkelje: shkelja e betimit të Presidentit, që bën fjalë për nenin 88, pika 3, të Kushtetutës; shkelja e detyrimeve kushtetuese të Presidentit për të qenë përfaqësuesi i unitetit të popullit, neni 86, pika 1, i Kushtetutës; shkelja e detyrimeve kushtetuese për të mos ushtruar asnjë aktivitet tjetër, përveç aktivitetit të Presidentit, neni 89 i Kushtetutës; shkelja e detyrimeve kushtetuese për të mos ushtruar asnjë kompetencë, që nuk është e parashikuar në Kushtetutë dhe në ligj, neni 94 i Kushtetutës; cenim i të drejtave kushtetuese të individëve, cenim i procesit zgjedhor; cenim i sigurisë dhe i rendit; cenim i marrëdhënieve me partnerët strategjikë të Shqipërisë; cenim i imazhit dhe reputacionit të vendit; cenimi i figurës së institucionit të Presidentit; abuzim me kompetencat kushtetuese të Presidentit. Ky komision duhet të hetojë dhe të japë konkluzione lidhur me ekzistencën e këtyre shkeljeve, si dhe të vërtetojë nëse këto shkelje janë të rënda, në mënyrë që t'i japim përgjigje kërkesës së kolegëve deputetë.

Në bazë të nenit 90, pika 2, të Kushtetutës shprehimisht thuhet: “Presidenti i Republikës mund të shkarkohet për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë”. Prandaj, bazuar në këtë parashikim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është detyrë e këtij komisioni të shqyrtojë, hetojë, analizojë dhe të japë gjetjen në lidhje me ekzistencën e shkeljeve dhe, nëse shkeljet e konstatuara nga ky proces hetimor janë të një natyre të rëndë për të justifikuar propozimin për shkarkimin e Presidentit.

Në lidhje me shqyrtimin e ekzistencës apo jo të shkeljeve të Presidentit, komisioni hetimor duhet të bazohet në të gjitha provat, faktet dhe rrethanat që rezultojnë nga aktet e administruara gjatë procesit hetimor, duke i analizuar këto fakte dhe rrethana në dritë të kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për çështjet objekt hetimi.

Lidhur me shqyrtimin për shkeljen e rëndë, në legjislacionin shqiptar në fuqi nuk kemi një parashikim të posaçëm se çfarë do të kuptohet me shkelje të rëndë të Kushtetutës, por referuar doktrinës kushtetuese, jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, vendime të cilat tashmë, ju kolegë, i keni; opiniononeve të Komisionit të Venecies për çështje të ngjashme, të cilat kanë ndodhur jashtë vendit tonë, të gjitha këto të referuara edhe në materialin kërkimor të shërbimeve të Kuvendit, që ju është plotësuar në dosjen tuaj të punës, por edhe në raportet e ekspertëve ligjorë, të cilët janë caktuar nga komisioni, komisioni hetimor mund të vlerësojë dhe të analizojë ekzistencën e shkeljes së rëndë në varësi të disa faktorëve, që në tërësinë e tyre përbëhen nga qëllimi i veprimeve apo akteve që rezultojnë në shkelje; rëndësia e ligjit apo të drejtës që shkelet nga veprimet që mund të rezultojnë në shkelej; konsistenca, që do të thotë përsëritja e veprimeve në shkelej; impakti, që do të thotë se çfarë pasoje ka sjellë kjo shkelje dhe, e fundit, qëndrimi që ka subjekti vetë ndaj sjelljes së kryer. Kjo, me pak fjalë, është natyra e punës së komisionit nga ky moment dhe deri në miratimin e raportit përfundimtar.

Ju vë në dijeni se kolegët deputetë në kërkesën e tyre kanë ngritur pretendime, në bazë të cilave është hartuar raporti dhe objekti i punës së këtij komisioni, i cili lidhet me disa nene të kushtetutës. Konkretisht, bëhet fjalë, siç e përmenda edhe më parë, për nenin 86, i cili thotë: “Presidenti i Republikës është Kryetar i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit”; neni 88, pika 3, i cili thotë: “Presidenti fillon në detyrë pasi bën betimin para Kuvendit, por jo më parë se të ketë mbaruar mandati i Presidentit që largohet. Presidenti bën këtë betim: “Beto hem se do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, do të respektoj të drejtat dhe liritë e shtetasve, do të mbroj pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe do t’i shërbej interesit të përgjithshëm dhe përparimit të popullit shqiptar.”; neni 89 i Kushtetutës, i cili thotë: “Presidenti i Republikës nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë anëtar partie dhe as të kryejë veprimtari tjetër private”; neni 94 i Kushtetutës thotë: “Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera, përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të”. Këto janë nenet e cituara në kërkesë, ndërkohë që në sajë të analizës merret në konsideratë i gjithë kuadri kushtetues dhe ligjor në Shqipëri.

Këtu dua ta vijoj diskutimin. Nëse do t’i referohemi ekzistencës së shkeljeve, në betimin e Presidentit një nga zotimet dhe përgjegjësitë, që merren përsipër nga ana e Presidentit, është edhe parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë që duhet t’i bindet dhe ta garantojë. Pra,

Presidenti zotohet që do t'i respektojë të gjitha aktet ligjore në këtë shtet, duke filluar që nga Kushtetuta dhe me të gjitha ligjet e tjera. Ky është një parim i shtetit të së drejtës, që sanksionohet në nenin 4 të Kushtetutës dhe nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore, sipas të drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për aq sa e lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Ky parim ka dy aspekte thelbësore: së pari, asnjë organ apo një institucion nuk mund të veprojë jashtë kompetencave që ligji i ka ngarkuar dhe, së dyti, këtij parimi nuk i nënshtrohen vetëm aktet e nxjerra gjatë ushtrimit të detyrës, por i nënshtrohet e gjithë veprimtaria e organit apo institucionit. Presidenti i Republikës, në këtë kuptim, është në ushtrim të veprimtarisë jo vetëm kur nxjerr dekrete apo jep dekorata, por edhe kur bën deklarime, kryen veprimtari protokollare, bën vizita zyrtare apo institucionale, pret vizitorë, jep intervista apo mban konferenca shtypi. E gjithë kjo veprimtari i nënshtrohet dhe matet nga parimi i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës.

Paragrafi 1 i nenit 86 të Kushtetutës përcakton pozicionin kushtetues të Presidentit në mozaikun e pushteteve, organeve dhe institucioneve kushtetuese të vendit. “Presidenti i Republikës është Kryetar i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit”. Ky pozicion kushtetues kondicionin jo vetëm statusin, por të gjithë veprimtarinë e Presidentit të Republikës. Shqipëria është republikë parlamentare, sipas paragrafit të parë të nenit 1 të Kushtetutës, që do të thotë se Presidenti i Republikës në Shqipëri është President joekzekutiv me rol formal ose protokollar. Pozicioni që ai mban karshi qeverisë apo forcave të tjera politike në çdo rast duhet të jetë asnjës dhe në çdo rast nuk duhet t'i referohet ndonjë orientimi politik të caktuar as pro dhe as kundër, as njërës dhe as tjetër palë. Presidenti është mbi palët; Presidenti nuk do të thotë se nuk duhet të kryejë veprimtari politike, por duhet të tregojë kujdes që të jetë neutral për të mos treguar anësi politike në ushtrimin e veprimtarisë dhe kompetencave të tij. Në fakt, edhe Komisioni i Venecies ka arritur në këtë konkluzion dhe sqaron më tej: “Çështja e të qenit neutral apo mbi palët e Presidentit nuk do të thotë se nuk duhet të ketë aktivitet partiak, por nuk duhet të mbajë anë politike pro apo kundër njërës palë dhe jo vetëm që Presidenti nuk duhet të mbajë kah, por duhet të duket që nuk mban kah në sytë e publikut, pra duhet të duket i paanshëm në sytë publikut”. Në fakt, kjo është asnjësia në ushtrimin e funksioneve, kushti dhe karakteristika thelbësore e pozicionit kushtetues të Presidentit.

Në fakt, roli kryesor i Presidentit është të jetë përfaqësues i unitetit të kombit. Uniteti do të thotë bashkim, pra të jetë përfaqësues i të gjithëve. Nëse e citoj Komisionin e Venecies në analizën që i ka bërë institucionit të Presidentit në opinionin e tij të fundit në lidhje me Shqipërinë për sa u përket zgjedhjeve të 30 qershorit, ka qartësuar se funksioni i Presidentit të

Republikës, si kryetar shteti dhe si përfaqësues i unitetit të popullit, kërkon që Presidenti i Republikës të mbajë pozicionin neutral në veprimtarinë e tij. Këto cilësime, cilësimi kryetar i shtetit dhe përfaqësues i unitetit kombëtar nuk kanë kuptimin se autoriteti i Presidentit i mbivendoset politikës. Ato kanë më tepër kuptimin se Presidenti duhet të qëndrojë jashtë politikës së palëve, me qëllim që të sigurojë, ndër të tjera, konkurrencën e drejtë midis palëve dhe funksionimin e rregullt të formës së qeverisjes dhe veprimtarive të tjera shtetërore. Domethënë, nëse Presidenti i shmanget apo shkel asnjësinë, atëherë pasojat bien mbi funksionimin e rregullt të formës së qeverisjes. Në këtë rast do të vuante organizimi shtetëror si republikë parlamentare dhe sovraniteti parlamentar; do të bien mbi balancën ligjore dhe konkurrimin politik; do ta vuajnë zgjedhjet e lira; do të bien mbi ndarjen dhe balancën midis pushteteve; do ta vuajnë funksionimi i rregullt i organeve ligjzbatuese, pavarësia e prokurorisë dhe e gjykatave, si dhe mbi ligjshmërinë e veprimtarisë shtetërore do ta vuajnë agjencitë dhe institucionet e administratës publike, administrata zgjedhore dhe qeverisja vendore. Pra, kjo është një analizë e bërë në vijim të një pasazhi të dhënë në opinionin e Komisionit të Venecias në lidhje me rolin neutral dhe mbipolitik që duhet të ketë Presidenti i Republikës, pasazh mbi të cilin kemi arritur në këtë analizë ose konkluzion që unë sapo ju përmenda, në gjykimin tim.

Funksioni përfaqësues formal dhe protokollar i Presidenti të Republikës është tipik për regjimet parlamentare. Statusi më i lartë midis autoriteteve publike i jepet Presidentit në regjimet parlamentare jo për shkak se është autoriteti më i pushtetshëm, por për shkak se objektivat që ngarkohen janë konceptuar të qëndrojnë përmbi dhe përtej politikave partiake. Nga ana tjetër, kushtetutat e pajisin Presidentin me tagra të posaçme pushteti formale, por edhe nga ana substanciale, me qëllim që të ndjekë këta objektiva. Nga kjo rezulton se, në ushtrimin e këtyre e tagrave, Presidenti jo vetëm sillet dhe duhet të sillet me asnjësinë, por duhet edhe të perceptohet se si sillet me asnjësinë. Presidenti në cilësinë e tij si kryetar shteti, ka të drejtë të përfaqësojë shtetin në marrëdhëniet me jashtë. Presidenti këtë tagër përfaqësimi nuk e ka të drejtë që t'ia nënshtrojë vullnetit të tij të pavarur.

Politika e jashtme dhe marrëdhëniet me shtetet apo përfaqësues zyrtarë të shteteve të tjera drejtohen nga Kuvendi si organ sovran dhe nga qeveria si një organ i ngarkuar me përcaktimin e drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore; përcaktim ky i bërë qartë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, paragrafi 1 i nenit 100 të Kushtetutës, paragrafi 2 i nenit 2 të Kushtetutës. Pavarësisht se Presidenti i Republikës së Shqipërisë pret ambasadorë ose të ngarkuar me punë të shteteve të tjera dhe letrat kredenciale të tyre, atij i mungon kompetenca materiale në fushën e marrëdhënieve me jashtë. Kompetenca e Presidentit për të përfaqësuar vendin nga jashtë është e kufizuar vetëm në drejtim të bërjes së një vullneti

shtetëror të formuar nga organet kompetente. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, kryetari i shtetit ka kompetencë që të ushtrojë të drejtën e shfaqjes së vullnetit në arenën ndërkombëtare, pra të bëjë të njohur ndërkombëtarisht vullnetin e brendshëm shtetëror dhe të përfaqësojë unitetin e shtetit në skenën ndërkombëtare. Presidentit i mungon tërësisht kompetenca për të formuar apo për ta modifikuar këtë vullnet. Ai nuk mund të caktojë aleat apo partneritet strategjik ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë. Nuk mund të kërkojë të negociojë apo të shpallë aleanca të ndryshme nga ato që ka përcaktuar Kuvendi i Shqipërisë, sikundër nuk mund t'i kontestojë, t'i denoncojë apo t'i prishë këto të fundit. Presidenti nuk mund të krijojë marrëdhënie të privileguara me shtete apo përfaqësues shtetesh të caktuara, sikurse nuk mund të distancojë shtetin shqiptar apo të krijojë incidente apo konflikte me shtete apo përfaqësues shtetesh jashtë përcaktimeve të politikës së jashtme të qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Në fakt, Presidenti nuk është pushteti i katërt në shtet, Presidenti nuk qeverisë dhe nuk administron, ai qëndron mbi të gjitha pushtetet, por nuk bën pjesë në to, konsiderohet si një organ *sui generis* dhe ushtron funksione që lidhen me gjyqësorin dhe me ekzekutivin. Pavarësisht se nuk bën pjesë në asnjë nga tri degët e pushtetit, Presidenti i Republikës është i detyruar të respektojë parimin e nenit 7 të Kushtetutës dhe bëhet fjalë për parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Ky parim shtrihet jo vetëm ndaj tri degëve të pushtetit ekzekutiv legjislativ dhe gjyqësor, por edhe ndaj organeve të tjera kushtetuese të pavarura, kompetencat e të cilave janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës. Sipas këtij parimi, asnjë organ në përbërje ose të një prej tri pushteteve nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese. Ky parim kushtetues nuk e lejon Presidentin që të instruktojë, të urdhërojë apo t'u kërkojë llogari strukturave të Policisë së Shtetit, prokurorisë, gjykatave apo institucioneve të tjera të pavarura që të kryejnë një punë apo për çështje që formojnë, në fakt, thelbin e veprimtarisë së tyre.

Nëse këtë shkelje kushtetuese Presidenti i Republikës e bën publikisht dhe shoqëron me thirrje dhe kërcënime kundrejt zyrtarëve specifikë të këtyre organeve, atëherë shkelja kushtetuese bëhet e rëndë, sepse mund të sjellë tularje, prapësim dhe devijim të funksionarëve nga ushtrimi i rregullt dhe ligjshëm i detyrës.

Neni 90 i Kushtetutës, paragrafi 1, përcakton përgjegjshmërinë e Presidentit për aktet e kryera në ushtrim të detyrës të tij. Në fakt, klauzola e paragrafit 1 të nenit 90 të Kushtetutës nuk është dispozitë mbi unitetin ndaj ndjekjes penale, sepse nuk mbulon veprime që Presidenti mund t'i kryejë gjatë ushtrimit të detyrës. Klauzola i jep Presidentit mbrojtje kundrejt përgjegjësisë politike, administrative apo civile; klauzola ndalon Kuvendin të kryejë mocion

mosbesimi apo të thërrasë në interpelancë Presidentin, por nuk e ndalon të nisë procedurat e shkarkimit për shkelje të rëndë të Kushtetutës apo për kryerjen e një krimi të rëndë. Në fakt, kryerja e një krimi të rëndë është një shkaqet për të cilat mund të nisët procedura e shkarkimit të presidentit, por kjo nuk do të thotë se Presidenti i Republikës mund të përgjigjet penalisht vetëm për krime të rënda dhe për të tjerat mbrohet nga ndjekja penale. Parimi themelor i Kushtetutës është se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit; është paragrafi 1 i nenit 18 të Kushtetutës dhe ky nen kërkon që Presidenti të mbajë përgjegjësi penale si çdo individë tjetër për çfarëdolloj veprë, për të cilën vendoset nën akuzë nga organi kompetentë.

Në nenin 223 të Kodit Penal “Thirrjet publike për veprime të dhunshme” përcaktohet se thirrjet e bëra publikisht për të kryer vepra të dhunshme kundër rendit kushtetues dënohen me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet. Rendi kushtetues, në fakt, formohet nga tërësia e parimeve themelore kushtetuese që përcaktojnë natyrën dhe organizimin e shtetit. Parlamentarizmi dhe zgjedhjet e lira janë komponentë thelbësorë të rendit kushtetues. Në Shqipëri Kushtetuta garanton liritë themelore dhe, përtej disa paqartësive dhe kundërthënive, Kodi Zgjedhor shërben si një bazë e përshtatshme për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, gjë që përfshin edhe mundësinë për ta kundërshtuar procedurën dhe rezultatin e zgjedhjeve. Procesi zgjedhor dhe rezultati i zgjedhjeve në një shtet ligjor mund të kundërshtohen vetëm me rrugë dhe me mjete të përcaktuara nga ligji dhe nuk ka asnjë shkak të ligjshëm që mund të justifikojë thirrjen për të kryer veprime të dhunshme apo gjuhë urrejtjeje me pasojë destabilizimin apo vënien në rrezik të zgjedhjeve. Vepra penale “Thirrje publike për veprime të dhunshme” bën pjesë në grupin e veprave penale kundër rendit kushtetues dhe mund të hetohet kryesisht. Ndërsa neni 266 i Kodit Penal “Thirrja për urrejtje” përcakton se vënia në rrezik e paqes publike duke bërë thirrje për urrejtje kundër pjesëve të popullsisë duke i fyer apo duke shpifur për to, duke kërkuar përdorimin e dhunës ose të veprimeve arbitrare përkundrejt tyre dënohet me burgim 2-8 vjet. “Thirrja për urrejtje nacionale” bën pjesë në grupin e veprave penale kundër rendit dhe sigurisë publike. Në fakt, kjo veprë drejtohet kundër pjesëve të popullsisë, të cilat duhet të jenë të identifikueshme qartë si objektiv sulmi. Përkatësia politike dhe motivi politik i sulmit mund të formojnë elemente të figurës së kësaj veprë. Kryerja ose jo e thirrjeve publike për veprime të dhunshme apo për urrejtje, në fakt, është çështja e hetimit penal të faktit. Për kuadrin ligjor ama të këtij hetimi parlamentar rëndësi ka të theksohet se legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë nuk përmban klasifikimin e veprave penale në krime të rënda apo lehta. Gjykimi nëse këto vepra formojnë krim të rëndë mund të orientohet vetëm nga fakti se ato drejtohen kundër rendit kushtetues apo rendit dhe sigurisë publike, të cilat formojnë fusha tepër sensitive të legjislacionit penal, sidomos kur ato vendosen në kontekstin e zgjedhjeve.



Kjo është një panoramë, nisur nga objekti i hetimit në këtë komision dhe nga kuadri ligjor ekzistues, i cili mund t'u shërbejë të gjithë kolegëve për sa i përket debatit në lidhje me provat.

Për sa më takon mua në lidhje me provat e administruara, në analizën e akteve që kemi marrë në shqyrtim, jemi duke shqyrtuar nëse ekzistojnë shkelje apo jo të Presidentit së Shqipërisë, të cilat janë shkelje kushtetuese dhe janë të rënda.

Së pari, dua të identifikojmë se cilat janë ato veprime apo fakte që pretendohen se janë shkelje. Bëhet fjalë për deklarata dhe qëndrime publike të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Në objektin e punës së komisionit është shtuar edhe hetimi në lidhje me mënyrën e ushtrimit të kompetencave të Presidentit, në raport me detyrimet e tij kushtetuese. Do t'u referohem nëveve përkatëse, të cilat, në fakt, në Kushtetutë normojnë aktivitetin e Presidenti dhe për të mos i lexuar, është neni që përcakton se Presidenti është përfaqësuesi i unitetit të popullit, nuk duhet të ushtrojë asnjë aktivitet tjetër përveçse atij të Presidentit dhe nuk duhet të marrë rol partiak, duhet të ushtrojë vetëm kompetencat që i njihen nga Kushtetuta dhe nga ligji dhe asgjë më tepër, dhe në formulën e betimit ka përgjegjësinë të respektojë Kushtetutën, ligjet, të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve, pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe t'i nënshtrohet mbrojtjes së interesit të përgjithshëm të vendit.

Çfarë na rezulton? Na rezulton që, sa u takon qëndrimeve të Presidentit, të cilat në shumë nga diskutimet e doktrinës kushtetuese, në fakt, nëse do u referohemi, mënyra e ushtrimit të kompetencave të Presidentit në një republikë parlamentare, ku Presidenti është kryetar i shtetit, por ka më shumë kompetenca formale, pra jo substanciale, ka vetëm pak lidhje me ushtrimin e detyrave që mund të kenë lidhje me pushtetin ekzekutiv apo me emërimet në gjyqësor, për shembull. Janë kompetenca, të cilat nuk shihen se ushtrohen vetëm me dekrete apo me akte që nxjerr Presidenti, por e gjithë mënyra e ushtrimit të funksioneve të Presidentit është pjesë e veprimtarisë së Presidentit. Kur flasim për përfaqësimin e unitetit kombëtar, ajo që duhet të kemi parasysh është që unitet kombëtar do të thotë interes i të gjithëve, do të thotë paqe, siguri, do të thotë që të gjithë njerëzit ta ndjejnë veten të përfaqësuar nga qëndrimet dhe nga ushtrimi i detyrave të Presidentit, dhe që të kenë një kryetar shteti, i cili u përgjigjet interesit të të gjithëve.

A është shkelur ky parim nga ana e Presidentit? Në fakt, ekspertët juristë na sollën në vëmendje doktrinën kushtetuese dhe raste të ngjashme në Kosovë apo në vende të tjera, ku jepet qartë se thirrjet pro apo kundër një force politike në procesin zgjedhor konsiderohen të papajtueshme me funksionin e përfaqësuesit të unitetit të popullit. Nga ana tjetër, këto thirrje

të kryera në mënyrë të përsëritur dhe të veshura me një natyrë, që përmban brenda gjuhë urrejtjeje apo thirrje kundër rendit dhe sigurisë, pa diskutim që cenojnë edhe një sërë situatash, të cilat gjejnë mbrojtje nga sistemi juridik shqiptar. Duke mos pasur kompetenca në lidhje me marrëdhëniet me jashtë, këto thirrje të Presidentit në lidhje me etiketime që bëhen për përfaqësues të partnerëve strategjikë, ambasadorë, apo të organizatave ndërkombëtare në një farë mënyre e nxjerrin Presidentit jashtë roli të vet, sepse siç e thamë, Kushtetuta e përcakton qartë se kush është kompetent për të përcaktuar linjat e politikës së jashtme në Shqipëri dhe Presidenti nuk është përfaqësues për të përcaktuar linjat e politikës së jashtme të Shqipërisë, por është thjesht në disa raste, siç e paracakton Kushtetuta, shprehësi i vullnetit të linjës të politikës me jashtë, që përcaktohet nga organe të tjera të shtetit, siç janë Kuvendi dhe Ekzekutivi, kështu që Presidenti nuk luan dot rol ta ndryshojë këtë vullnet për politikën e jashtme, ashtu sikundër nuk ka dot rol ta shfaqë ndryshe këtë politikë të jashtme.

Nëse do u referohemi të gjitha akteve që kemi administruar në dosje, në lidhje me këto dy çështje, pra unitetin e kombit dhe parashikimet kushtetuese për përgjegjësinë që ka Presidenti në lidhje me politikën e jashtme dhe marrëdhëniet me shtetet dhe përfaqësuesit zyrtarë të shteteve të tjera, në të gjitha deklaratat, në të gjitha daljet apo qëndrimet publike, unë i çmoj se jemi përpara shkeljeve, të cilat janë të përcaktuara qartë në nenin 86 të Kushtetutës, në nenin 88, pika 3 “Betimi i Presidentit”, si dhe nenin përkatës të Kushtetues që parashikon detyrat sa i takon kompetencave për marrëdhëniet me jashtë të Republikës së Shqipërisë. Nëse këto veprime, akte, të cilat janë shkelje janë të rënda apo jo, unë do të konsideroj që ne duhet t’i analizojmë në përputhje me qëllimin e veprimeve dhe akteve që përbëjnë shkelje, duhen parë në dritën e rëndësisë së ligjit të shkelur, duhen parë në lidhje me konsistencën, përsëritjen dhe duhen parë në lidhje me impaktin që kanë lënë në publik, si dhe sjelljen e Presidentit në lidhje me këto shkelje.

Nëse i referohemi qëllimit, duhet qartësuar që në deklaratat e Presidentit, në qëndrimet zyrtare, në tërësinë e akteve, nga provat që kam shqyrtuar nuk vihet re ndonjë orientim koordinues i organeve kompetente për të vepruar në favor të respektimit të Kushtetutës apo ndërmarrja e ndonjë veprimi konkret, sipas mekanizmave që parashikon Kushtetuta dhe ligji, për të rivendosur ndonjë të drejtë që Presidenti e pretendon se në Shqipëri po nëpërkëmbet. Flasim për mbrojtjen e zgjedhjeve të lira, flasim për respektimin e të drejtave kushtetuese në procesin zgjedhor, por ndërkohë do t’i shkonte Presidentit të kryente shumë veprime, të cilat si përfaqësues i unitetit kombëtar u tërheqin vëmendjen institucioneve që pretendon se nuk po veprojnë siç duhet? Ne vëmë re që ka shkresa për intimidim në institucionet e pavarura, siç është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka thirrje ndaj organit të Prokurorisë ku i kërkohet të

mbyllë se s'bën një hetim brenda një afati të caktuar, ndërkohë që organi i Prokurorisë është i pavarur. Askush nuk mund të ndikojë për formësimin e vullnetit dhe të ushtrojë presion ndaj një organi të pavarur.

Nuk vihet re që të kemi ndonjë qëndrim që në fakt, i shkon për shtat figurës së unitetit të popullit, sepse edhe deklaratat kundër Policisë së Shtetit (nuk mund ta themi kështu, por ta themi në thonjëza), fakti që në disa prej deklaratave, që i kemi përpara, thuhet që “të anashkalohej Policia e Shtetit, sepse nuk do të veprojmë me atë polici, por do të veprojmë me policinë e popullit”, është një etiketim i cili u bëhet organeve të shtetit shqiptar, duke sjellë si pasojë edhe cenimin e figurës dhe të besimit të publikut që ka në këto institucione dhe që në fakt duhet të kenë, sepse një nga rregullat kryesore në demokraci, është besimi i publikut tek institucionet. Nëse ne do të kemi këdo zyrtar, jo më Presidentin e Republikës së Shqipërisë që etiketon institucionet e shtetit me këtë gjuhë, është shkelur një nga elementet kryesore të respektimit të institucioneve të vendit, të ligjërisë të punës së institucioneve.

Pra, intimidimi i institucioneve, nuk mund të jetë një qëllim i ligjshëm. Pra, nëse i marrim në tërësinë e tyre, unë mendoj se, nuk ka qëllim legjitim në deklaratat e Presidentit. Nëse i marrim të gjitha këto deklarata, me rëndësinë ligjit dhe të së drejtës së shkelur, deklaratat janë bërë në kohën e zgjedhjeve. Kemi përpara një sërë praktikash të Komisionit të Venecias edhe të Gjykatës Kushtetuese, të cilat, në fakt flasin për të drejtën për të zgjedhur dhe të drejtën për t'u zgjedhur, si dy elemente, të cilët janë të drejta që flenë, por zgjohen në momentin kur kemi procese zgjedhore. Këto të drejta duhet të ushtrohen lirisht nga shtetasit, të cilët në fakt, duhet të jenë të lirë të formojnë vullnetin e tyre, se për cilën forcë politike apo për cilën forcë tjetër politike do të votojnë.

Në materialin e ekspertëve ligjorë keni një sërë analizash, të cilat arrijnë në konkluzionin se, kur jepen mesazhe pro apo kundër njëres forcë politike, ndërhyhet në të drejtën për t'u zgjedhur të subjekteve, pra ata nuk janë të lirë ta formësojnë vendimin e vet, dhe e thënë këtë formë, dal nga roli i përfaqësuesit të unitetit të kombit, kur ndërhyhet në një proces që është proces zgjedhor, është shkelur e drejta për të zgjedhur që bën pjesë në grupin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, e cila për nga rëndësia apo hierarkia e ligjeve mbrohet me ligje që mbizotërojnë pra në hierarkinë e ligjeve në nivelin më të lartë, janë të drejta dhe liri që garantoohen nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

E njëjta gjë edhe për të drejtën për t'u zgjedhur. Pra, këto thirrje krijojnë diferencim, krijojnë ndasi politike, krijojnë etiketime, të cilat nuk mund të mos ndikojnë dhe impaktojnë zgjedhësit për të krijuar një bindje të vetën, duke mos qenë të lirë në gjykimin e vet. Është normale të ndodhë kjo, kur subjektet politike garojnë dhe sigurisht kanë gjuhën përkatëse sesi

ata e bëjnë fushatën, në mënyrë që të bindin votuesit t'i votojnë ata. Mund të flasin kundër subjektit tjetër politik, por nga askush dhe kurrë një subjekt që është përfaqësues i neutralitetit, i unitetit kombëtar dhe nuk përbën subjekt politik, nuk duhet të veprojë sikur është një subjekt politik, përndryshe, siç thotë edhe e drejta kushtetuese italiane, “Do të kishim një parti tjetër në zgjedhje dhe që do të ishte partia e Presidentit”. Jurisprudenca italiane, në fakt, Presidentin e sheh edhe pak më ndryshe, ajo thotë: “Dhënia e mesazheve që jep Presidenti duhet të jetë vetëm në Kuvend”, duhet më jetë më i rezervuar, sepse në fakt, nuk ka të bëjë vetëm me mënyrën se si ushtrohen kompetencat e Presidentit, por me mënyrën se, nëse Presidenti lirinë e shprehjes nuk e kufizon deri në atë masë, që vetëm t’i shërbejë interesit të përgjithshëm apo paqes, sigurisë, rendit dhe sidomos rolit kryesor të tij si moderator i zgjidhjes së krizave politike, do të kthehet në një rutinë, e cila, nëse nuk do të merret në konsideratë nga organe të tjera të shtetit, pra, një mesazh në funksion të rendit, sigurisë apo të paqes politike dhe sociale, nëse nuk jepet në mënyrën e duhur, por përsëritet aq herë dhe nuk vjen në përputhje me parimin e interesit të përgjithshëm, rrezikon edhe që të mos merret në konsideratë mesazhi apo qëndrimi përkatës i Presidentit duke ulur edhe autoritetin e tij. Nëse ulet autoriteti i institucionit të Presidentit, në fakt, ulet siguria dhe garancia që institucionet janë duke i ushtruar më së miri detyrat e veta.

Pra, për mua, këtu kemi të bëjmë me një shkelje që lidhet me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, siç është e drejta për të zgjedhur dhe e drejta për t’iu zgjedhur. Këto janë shkelje kushtetuese të atyre të drejtave , të cilat, në fakt, në hierarkinë e marrëdhënieve shoqërore, që mbrohen dhe garantohen nga legjisllacioni, janë në nivelin e parë, sepse mbrohen nga Kushtetuta dhe janë të paprekshme, përveç kufizimeve që mund të jepen me ligj në mënyrë proporcionale dhe kur janë të justifikuar në demokraci, por nuk rezulton që jemi para këtij rasti.

Ndërkohë, marrëdhëniet e tjera, të cilat janë cenuar me shkelje, janë rendi dhe siguria. Flasin për të drejtën e qytetarëve për të jetuar paqësisht në një vend, por kemi dëgjuar thirrje, të cilat, të thëna nga ana e Presidentit, duke etiketuar armë të ndryshme të kohës së Mesjetës, duket sikur u kërkon qytetarëve të ngrihen kundër një regjimi, i cili është aq i rëndë sa vetëm me këtë formë me këtë zgjidhet. Duket sikur këtu në Shqipëri nuk jemi në demokraci, nuk funksionon shteti i së drejtës, nuk funksionojnë mekanizmat e tjerë.

Pavarësisht se ne nuk po hetojmë faktin penal, por elementet e thirrjeve kundër rendit dhe sigurisë apo urrejtjen e të tjera, janë të mjaftueshme për ne për të kuptuar në analizën e rëndësisë së ligjit që shkelet se kemi të bëjmë në fakt me një marrëdhënie të rëndësishme

shoqërore, siç është rendi dhe siguria, të cilat mbrohen nga Kodi Penal i miratuar me shumicë të cilësuar.

Nga ana tjetër, është e rëndësishme të kuptohet se, siç e thamë, edhe politika me jashtë është shumë e rëndësishme, si një marrëdhënie apo çështje që rregullohet drejtpërdrejt nga Kushtetuta. Shkelja e nenit përkatës të Kushtetutës, i cili i jep kompetencën e politikës së jashtme dhe linjës së politikës së jashtme ekzekutivit apo Presidentit është e tillë që të rëndësia e çështjes apo shkeljes që bëhet lidhet me një shkelje të rëndë të Kushtetutës.

Ndërkohë, nëse flasim për konsistencën apo përsëritjen e shkeljes, janë një sërë deklaratash publike në rrjetet sociale, një sërë emisionesh televizive. Nëse do t'i rendisim siç janë lexuar dje nga zoti Hyseni dhe janë administruar në dosje, kemi të bëjmë me veprime të përsëritura, por jo vetëm kaq, vëmë re që edhe dy shkresat e paraqitura në komisionin hetimor, në vijim të thirrjes që u bë Presidentit për të marrë pjesë dhe për t'u dëgjuar në lidhje me pretendimet e veta për këtë çështje, kanë pothuajse të njëjtin qëndrim si në ato deklaratat apo pozicione, të cilat janë marrë në hetim nga ky pozicion apo gjuha e përdorur është e tillë që përsëri tregon një konsistencë në veprimet e Presidentit dhe nuk vihet re që të kemi një ndryshim në këtë sjellje.

Për sa i takon impaktit, ai nuk është i palexueshëm. Impakti i këtyre sjelljeve është i tillë që, në fakt, ndihet në shoqëri që nuk është moderuar konflikt politik gjatë fushatës zgjedhore, ka pasur ndasi sociale, nuk është garantuar uniteti kombëtar, ka pasur problematika në lidhje me komunikimin me përfaqësues të shteteve të huaja që janë në Shqipëri, të cilat e kanë cenuar në një farë mënyre edhe këtë marrëdhënie në kuptimin publik, por jo në kuptimin thelbësor, sepse, siç e thashë, politika e jashtme është e tillë që është kompetencë e ekzekutivit dhe për aq sa mundet, sipas Kushtetutës, dhe Kuvendit.

Gjithsesi, reputacioni i Shqipërisë në këtë drejtim jo se nuk është cenuar, për sa kohë që episode të qëndrimeve të Presidentit ndaj përfaqësues të institucioneve të huaja, sidomos ndaj ambasadores së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, jo vetëm janë shpërndarë nëpër mediet e brendshme, por edhe në ato të huaja, si "Uashington Post", të cilat në një farë mënyre jo vetëm kanë pasur një impakt në krijimin e një opinionit publik që imazhin e vendit sigurisht nuk e rregullojnë, përkundrazi, e dëmtojnë, por edhe zyrën e institucionit të Presidentit të Republikës e kanë cenuar.

Këtu, në fakt, kemi marrë në analizë edhe mënyrën si janë ushtruar një sërë kompetencash nga ana e Presidentit të Republikës, nisur edhe nga memot dhe informacionet e kërkuara në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Ne kemi parë që ka një numër të madh ligjesh të kthyer nga ana e Presidentit të Republikës. Nga të gjitha këto ligje, vetëm një ose dy ligje mund të jenë kundërshtuar nga ana e Presidentit në Gjykata Kushtetuese për antikushtetutshmëri. Shumica e ligjeve janë të punuara me partnerët tanë ndërkombëtarë, kryesisht, Bashkimin Europian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. E kthyer tashmë në një traditë kushtetuese çështja e kthimit të ligjeve nga Presidenti në Kuvend, për ne e pabazë dhe në abuzim të kompetencave të tij kushtetuese, nuk ka bërë vetëm të krijohet kjo traditë e pazakontë, sepse siç ju thashë, për sa kohë kthehen ligje ... Vetëm dy ligje janë dërguar për t'u kundërshtuar në Gjykatë Kushtetuese. Pra, nuk është përdorur asnjë mjet tjetër ligjor apo kushtetues se si mund të ushtrohen të drejtat që mund të ketë Presidenti për t'i denoncuar ato që i konsideron jo të drejta në funksionimin dhe organizimin e shtetit. Nga ana tjetër, të gjitha këto çështje, që kanë të bëjnë me kthimin e ligjeve kanë sjellë hyrjen e vonuar në fuqi të nismave ligjore, të cilat në fakt nuk është se kanë pasur pak impakt në ekonomi në financat e vendit, në të drejtat e shtetasve, që janë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Pra, në njëfarë mënyre edhe veprimi i kthimit të ligjeve me dekrete në mënyrë të patakt, të kthyer tashmë në një "traditë presidenciale" të këtyre kohëve, ka bërë që ne të kemi një impakt në rregullimin e veprimtarisë në përgjithësi në shoqëri dhe shtet. Edhe gjithçka tjetër që thashë në lidhje me mosqenien si përfaqësues i unitetit kombëtar, mospërfaqësimin e vullnetit të ekzekutivit dhe të Kuvendit për sa i takon politikës me jashtë, sidomos me Shtetet e Bashkuara të Amerikës apo me vende të tjera, të cilat, në fakt, i marrim si çështje që dalin nga deklaratat e Presidentit, pra, mënyra se si etiketohen, se si u referohet atyre, janë në thelb shkelje kushtetuese të rënda.

Qëndrimi i subjekti ndaj shkeljes është një qëndrim, në fakt, i cili duhet parë pikërisht për të kuptuar se jemi para shkeljes së rëndë apo jo.

Ne kemi kërkuar disa herë që Presidenti i Republikës të jetë prezent këtu. I kemi dhënë të gjitha mundësitë: të jetë i pranishëm, të shprehë qëndrimin e tij, të japë pikëpamjet e veta në lidhje me këtë proces hetimor. Nga Presidenti nuk ka pasur vullnet për t'u paraqitur, por ka sjellë komunikime me shkrim që nuk e njeh këtë komision hetimor, që nuk e njeh legjitimitetin e tij, që ky është një proces që po bëhet për hakmarrje ndaj Presidentit. Në fakt, i akuzuar për shkelje të rënda kushtetuese nuk është ky komision, por Presidenti i Republikës së Shqipërisë. Për të gjitha pretendimet që nxjerrin kolegët tanë deputetë në kërkesën e tyre, për të gjitha çështjet e hetimit që ne jemi duke hetuar këtu, për çdo material që ne kemi administruar si provë dhe do të duhet të japim një gjykim tonin dhe në fund edhe një vlerësim, do të duhet Presidenti i Republikës të japë sqarimet e tij. Nuk jemi ne të akuzuar. Me sa shikoj, ky lloj

raporti midis Kuvendit dhe Presidenti të Republikës së Shqipërisë nuk mund të funksionojë më për sa kohë, nëse do të lexoni dhe besoj e keni lexuar kolegë, shkresat drejtuar Kuvendit janë jashtë atyre që konsiderohen parime të ushtrimit të drejtë të detyrës nga çdolloj funksionari e jo më nga Presidenti i Republikës.

Këto janë në një farë mënyre gjetjet paraprake që unë shikoj në bazë të provave dhe në bazë të së drejtës që ka marrë në analizë, pak a shumë edhe për të ndihmuar kolegët se cilat janë çështjet e këtij debati.

Faleminderit!

**Alket Hyseni** – Faleminderit, zonja Bushka!

Zoti Çaçani.

**Arlind Çaçani** – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë!

Komisioni hetimor i ngritur me vendimin e Kuvendit po merr në shqyrtim kërkesën e 1/4-s së deputetëve për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

Qëllimi i ngritjes së këtij komisioni është verifikimi i mënyrës së ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore nga ana e Presidentit gjatë periudhës para, gjatë fushatës zgjedhore, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

Objekti i këtij komisioni është i qartë: verifikimi nëse aktet e kryera nga Presidenti në ushtrimin e kompetencave të tij kanë pasur pasoja në parimin e unitetit të popullit, prishjen e ekuilibrit politik, të qetësisë publike, të nxitjes së urrejtjes dhe dhunës, vënien në rrezik të jetës të njerëzve, ndërhyrjen dhe intimidimin e institucioneve publike, dëmtimin e imazhit dhe reputacionin e vendit, si dhe marrëdhëniet me partnerët strategjikë të Shqipërisë; verifikimi i akteve, sjelljeve dhe qëndrimeve të caktuara të Presidenti të Republikës në raport me rolin dhe pozitën e tij kushtetuese.

Komisioni hetimor gjatë punës së tij në të gjitha mbledhjet për të realizuar objektivat dhe detyrat për të cilat është ngritur, ka ndërmarrë një sërë veprimesh procedurale në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 8891, datë 02.05.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore”.

Komisioni hetimor miratoi planin hetimor duke përcaktuar qartë të gjitha veprimet që duhej të bënte ky komision që nga thirrja e Presidentit, kërkesa për marrjen e informacioneve apo dokumenteve zyrtare nga institucionet e ngarkuara me ligj, caktimi i ekspertit për t’iu përgjigjur pyetjeve që u ngritën për një ekspertizë më të mirë dhe të kualifikuar për qëndrimet e Presidentit.

Komisioni u njoh dhe e shqyrtoi të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e dërguar nga Autoriteti i Medieve Audiovizive lidhur me deklaratat e dhëna nga Presidenti në mediet e shkruara, si dhe kasetat filmike të mesazheve dhe deklaratave të dhëna nga Presidenti i Republikës në mediet audiovizive lidhur me objektin e hetimit të këtij komisioni. Gjithashtu, u nxorën nga rrjetet sociale edhe mesazhet e Presidentit dhe qëndrimet e mbajtura prej tij në raport me zgjedhjet.

Nga të gjitha materialet që iu vunë në dispozicion anëtarëve të këtij komisioni, por edhe u panë gjatë zhvillimit të mbledhjes së këtij komisioni, tregohen qartë veprimet e Presidentit Ilir Meta në periudhën para dhe gjatë fushatës zgjedhore, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore, të cilat janë në kundërshtim me përcaktimin kushtetues të rolit dhe funksionit të Presidentit të Republikës. Ndër të tjera, flagrant ishin debati i zhvilluar në datën 15.03.2021 te një media “Syri TV” me gazetarin Çim Peka, ku Presidenti deklaroi për “Sfurqe, si gratë e Libofshës” e të tjera, deklarata të cilat nuk përkojnë me përcaktimet kushtetuese të Presidentit, sepse presidenti është përfaqësues i unitetit të të gjithë popullit, si dhe e gjithë retorika e zhvilluar në lidhje me marrëdhëniet me partnerët strategjikë të Shqipërisë, si BE-ja dhe SHBA-ja. Gjithashtu, ndër shkeljet e hapura të Presidentit ishte edhe deklarata një ditë para zgjedhjeve, duke thyer ditën e heshtjes zgjedhore.

Shqipëria është një republikë parlamentare dhe Presidenti, kreu i shtetit, konsiderohet si një mishërim i unitetit të popullit. Por Presidenti i Republikës me veprimet e tij a ka qenë me të vërtetë mishërim i unitetit të popullit?

Në tejkallim të kompetencave kushtetuese dhe në shkelje të rënda të Kushtetutës, zoti Ilir Meta, para dhe gjatë periudhës së fushatës zgjedhore me veprime dhe mesazhet e dhëna nuk ka garantuar unitetin kombëtar, nuk ka moderuar konfliktin politik, përkundrazi, e ka nxitur atë me anën e thirrjeve luftarake dhe përdorimin e epiteteve të dhunës për vetëgjyqësi.

Ekspertët janë shprehur se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka sanksionuar që Presidenti është përfaqësues i unitetit të popullit dhe kërkon që te figura e Presidentit të evidentohen disa cilësi që, ndër të tjera, janë: paanshmëria politike, neutraliteti, reflektimi i interesit të popullit dhe i shtetit në vendimet dhe veprimet e tij, kujdesi i vazhdueshëm për ruajtjen e të mirës publike e të tjera.

Nga ekspertët u theksua që edhe në praktikën e vendeve me legjislacion të ngjashëm me sistemin kushtetues shqiptar, parimi i zbatueshmërisë nga Presidenti është ai i vetëpërmbytjes.

Nga analiza e kryer nga ekspertët për kompetencat e Presidentit rezultoi se kryetarët e shteteve me sistem qeverisës “republikë parlamentare” kanë funksione simbolike dhe ceremoniale. Ata mishërojnë autoritetin shtetëror dhe janë gjithashtu mbi palët.



Edhe në disa raste theksohet që Presidenti nuk ushtron funksionin e drejtimit politik të një shteti, detyra që lidhen kryesisht me parlamentin dhe qeverinë.

Në kryerjen e detyrës së tij si kreu i shtetit, Presidenti i Republikës, sipas nenit 83, duhet të veprojë në një linjë të mirë publike për të gjithë shtetin dhe jashtë çdo linje të ngushtë partiake apo personale.

Funksioni i kreut të shtetit është funksion që kërkon integritet neutral dhe përmbajtje meritore, meqenëse materializmi i vendimeve në kuadër të këtij funksioni duhet të përfaqësojë të mirën publike shtetërore përpara interesave elektorale apo partiake.

Për sa më lart, zoti Ilir Meta, në detyrën e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, ka humbur rolin e përfaqësuesit të unitetit kombëtar dhe moderatorit të konfliktit politik. Përkundrazi, me mesazhet e tij drejtuar publikut në periudhën para, gjatë dhe pas fushatës zgjedhore ka treguar qartë se linja e tij politike është e qartë. Presidenti ka kryer veprime të njëanshme partiake që bien ndesh me nenin 89 të Kushtetutës.

Edhe opinioni i Komisionit të Venecies në qëndrimin e mbajtur në lidhje me rolin e Presidentit, midis të tjerash, është shprehur se Presidenti duhet të mbetet jashtë politikës partiake, me qëllim që t'i shërbejë mes të tjerash një konkurrence të ndershme midis partive dhe funksionit të rregullt të formës së qeverisjes dhe aktiviteteve të tjera të shtetit.

Për sa më lart, në bazë të të gjitha fakteve, si dhe opinioneve të ekspertëve lidhur me rolin e Presidentit dhe shqyrtimin në këtë komision hetimor të të gjitha provave, ka rezultuar se Presidenti i Republikës me deklarata dhe veprime ka shkelur rëndë disa dispozita kushtetuese të parashikuara në nenin 86, pika 1, nenin 89 dhe nenin 94 të Kushtetutës.

Vlen të theksohet fakti që komisioni hetimor, në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit “Për komisionet hetimore”, iu drejtua Presidentit duke e ftuar disa herë të realizojë të drejtën e tij për t'u shprehur dhe për të dhënë opinionin e tij. Por nga ana e Presidentit të Republikës, me letër dërguar komisionit të Shqipërisë, pretendohet se nuk e njeh komisionin hetimor, duke e quajtur atë jolegjitim dhe ka refuzuar kërkesën e paraqitjes në komision hetimor.

Ndryshe nga sa parashtrohet Presidenti i Republikës në letrën e tij, komisioni hetimor është legjitim. Ai është ngritur konform kërkesave kushtetuese dhe ligjore, dhe është po aq legjitim sa edhe Kuvendi aktual, i cili, në zbatim të Kushtetutës, po e ushtron veprimtarinë e tij deri në mbarimin e këtij mandati kushtetues.

Mosparaqitja e Presidentit pranë këtij komisioni nuk e zbeh punën e tij dhe seriozitetin me të cilin ka punuar për administrimin dhe për shqyrtimin e dokumenteve dhe për të arritur në konkluzionin se kërkesa e 49 deputetëve drejtuar Kuvendit për shkarkimin e Presidentit të Republikës për shkelje të rënda kushtetuese është apo jo legjitime.

Unë e shikoj vendimin e Presidentit të Republikës për të mos njohur komisionin si një shmangie për t'i ikur së vërtetës. Presidenti është i vetëdijshëm për veprimet antikushtetuese dhe për këtë arsye nuk ka dashur që të jetë para komisionit për të dhënë shpjegime.

Si përfundim, pasojat e ardhura nga shkeljet kushtetuese të kryera nga Presidenti i Republikës çojnë në shkarkimin e tij për moszbatim të kompetencave të tij kushtetuese.

Faleminderit, zoti kryetar! Kaq kisha.

**Alket Hyseni** – Faleminderit, zoti Çaçani!

Zonja Hysi, fjala për ju.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuara kolege dhe kolegë të këtij komisioni,

Në radhë të parë, më lejoni të falënderoj sekretarinë e komisionit për vënien në dispozicion të një materiali shumë të bollshëm që ne të gjithë e kemi përpara që na mundëson që sot të bëjmë një diskutim në parim lidhur me çfarë kanë depozituar kolegët firmëtarë, por edhe me të gjitha provat që ne kemi administruar.

Në fakt, do ta nisja pikërisht nga ajo çfarë thotë Kushtetuta dhe nga objekti i komisionit hetimor.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 90, pika 2, më lejoni ta citoj, thekson se Presidenti i Republikës mund të shkarkohet për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë; nuk po vijoj me tjetrën. Pra, fjalët kyçe janë, e para, “shkelje”, “shkelje e rëndë”, e dyta, dhe “shkelje e Kushtetutës” e treta. Po e nis nga fjala “Kushtetutë” që është ligji më i lartë në hierarkinë e normave.

Në këtë kuadër, do të doja të theksoja se roli ynë si anëtarë të komisionit hetimor është të vlerësojmë pikërisht raportet ose parashikimet që përmban Kushtetuta në raport me organizimin dhe funksionimin e institucionit të Presidentit të Republikës.

Kushtetuta që në nenin 3 të saj thekson se jemi një vend, ku pavarësia e shtetit, tërësia, dinjiteti i njeriut, të drejtat e të tjera janë parimet mbi të cilat ngrihet dhe funksionon shteti, si dhe në nenin 4 të Kushtetutës thuhet se e gjithë veprimtaria e shtetit bazohet tek e drejta. Pra, kur flasim për veprimtarinë e shtetit, edhe veprimtaria e Presidentit të Republikës bazohet tek e drejta. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë. Pra, edhe për Presidentin e Republikës Kushtetuta është ligji më i lartë.

Gjithashtu, unë do të doja të theksoja edhe nenin 7 të Kushtetutës, ku theksohet se sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve. Dhe cilat janë pushtetet? Është pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe ai gjyqësor. Pra,

nuk ka një pushtet të katërt. Presidenti nuk përfaqëson një pushtet të katërt. Madje, edhe këto tri pushtete duhet të jenë të ndara dhe të balancuara me njëri-tjetrin.

Në këtë kuadër, i përmenda nenin 3, nenin 4, paragrafët 1 dhe 2, dhe nenin 7 për të kuptuar se të gjitha institucionet dhe veprimtaria e tyre duhet të bazohet në Kushtetutë dhe organizimi e funksionimi i tyre rregullohet edhe me ligjet përkatëse, përveçse kur Kushtetuta parashikon ndryshe; ky është neni 6 i Kushtetutës.

Dikush mund të pyesë pse po i citoj këto nene. Kjo është korniza ligjore e organizimit dhe funksionimit të veprimtarisë së shtetit dhe të çdo institucioni të lartë, duke filluar që nga institucioni i Presidentit të Republikës tek institucionet e tjera.

E dyta që ka të bëjë është betimi që bën Presidenti kur fillon detyrën.

Pikërisht edhe në formulën e betimit fjalët kyçe janë: Kushtetutë dhe ligjet e vendit. Pra, Presidenti u bindet Kushtetutës dhe ligjeve të vendit; respekton të drejtat dhe liritë e shtetasve, mbron pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe i shërben interesit të përgjithshëm. Pikërisht te formula e betimit për komisionin tonë janë me rëndësi termat “Kushtetutë”, “ligje”, “respektim i lirive dhe i të drejtave të njeriut”, si dhe “shërbimi në interes të përgjithshëm”. Por a përbëjnë sjelljet, veprimet dhe aktet e Presidentit të Republikës një respektim të betimit apo shkelje, siç do ta shtjelloj edhe në vijim?! Del e qartë që betimi nuk është respektuar, madje jo vetëm që nuk është respektuar, por është shkelur rëndë.

Një aspekt tjetër tek i cili do të doja të ndalesha, pa dashur ta përsëris kolegen Bushka, është neni 15 i Kushtetutës, i cili flet për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Në paragrafin e dytë të tij thuhet se organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre, pra asnjë institucion nuk ka imunitet që të mund të shkelë liritë dhe të drejtat e njeriut. Edhe kufizimi i tyre bëhet me ligj, por se ku kufizohen dhe në çfarë shkalle, apo mbi cilat standarde, parime, ose kritere kufizohen, përcaktohen në nenin 17 të Kushtetutës.

Në këtë kuadër do të doja të theksoja një çështje të dytë, të nderuar kolegë, kompetencat e Presidentit të Republikës. Presidenti shpesh justifikohet me fjalët se ai ka të drejtë të mbrojë Kushtetutën, Republikën dhe është në ushtrim të kompetencave kushtetuese. Kompetencat e Presidentit të Republikës rregullohen në nenin 92. Po marr vetëm 4 kompetenca, që mund të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me argumentet, ose me kërkesën e kolegëve të nderuar.

Presidenti i drejton mesazhe Kuvendit, por nuk thuhet në nenin 92 të Kushtetutës shkronja “a” që Presidenti i drejton mesazhe Policisë së Shtetit, prokurorit, gjykatave, prokurorëve të posaçëm të krijuar me ligj për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në nenin 92, shkronja “e” thuhet që Presidenti pranon letra kredenciale dhe

tërheqjen e përfaqësuesve diplomatikë të shteteve të tjera dhe të organizatave ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Shqipërisë, por në këtë nen të Kushtetutës nuk thuhet që Presidenti u tërheq vëmendjen përfaqësuesve diplomatikë. Presidenti i përflet, i shan, i kërcënon, i denigron dhe i cenon marrëdhëniet e miqësisë, të bashkëpunimit dhe reputacionin e Republikës së Shqipërisë. Në shkronjën “gj” të këtij neni, pra të nenit 92 të Kushtetutës, theksohet që Presidenti cakton datën e zgjedhjeve për Kuvendin, për organet e pushtetit vendor dhe për zhvillimin e referendumeve, por në këtë pikë të Kushtetutës, nuk i është dhënë kompetencë Presidentit të Republikës të administrojë zgjedhjet, të shprehet dhe t’i certifikojë ato nëse janë të ligjshme, apo jo, kanë pasur, apo jo shkelje, apo të bëjë thirrje për zhvillimin e referendumeve, sepse neni 92 përcakton thjesht caktimin e datës së zgjedhjeve.

Gjithashtu në shkronjën “h” të nenit 92 të Kushtetutës thuhet që Presidenti kërkon mendim dhe të dhëna me shkrim nga drejtuesit e institucioneve shtetërore për çështje që kanë të bëjnë me detyrat e tyre dhe konkretisht Presidenti ka të drejtë të kërkojë mendim, informacion, por nuk thuhet që Presidenti gjykon, kërcënon, intimidon institucionet dhe parashikon, ose shpreh vetëgjyqësinë.

Në këtë kuadër, këto nene të Kushtetutës që përmenda janë baza mbi të cilën vlerësoj se duhet të vijojmë me shqyrtimin e kërkesës.

Nga ana tjetër, në nenin 94 të Kushtetutës thuhet që Presidenti nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që njihen shprehimisht në Kushtetutë dhe jepen me ligje, që nxirren në pajtim me Kushtetutën. Pa dyshim që në rastin konkret unë iu referova Kodit Zgjedhor.

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i miratuar me ndryshimet pas marrëveshjes së 5 qershorit, i cili u dekretua menjëherë nga Presidenti i Republikës, shprehet konkretisht në lidhje me institucionet, që administrojnë, vlerësojnë dhe certifikojnë zgjedhjet. Në këtë kuadër në nenin 12 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar në vitin 2021 dhe ky nen ka ndryshuar me ligjin nr. 101 të vitit 2020 në datë 23.07.2021, thuhet që KQZ-ja është institucioni përgjegjës për organizimin, administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve dhe që drejton e mbikëqyr veprimtarinë e administratës zgjedhore, monitoron veprimtarinë e subjekteve zgjedhore të organeve dhe institucioneve të medias në raport me zgjedhjet, si dhe zgjidh në rrugë administrative kërkesat dhe ankesat.

Pse lexova paragrafin e parë të nenit 12 të Kodit Zgjedhor? Sepse është një institucion tjetër dhe nuk është Presidenti i Republikës ai që duhet të monitorojë, apo të jetë vëzhguesi i zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë dhe që duhet të mbikëqyrë veprimtarinë se si punon Policia e Shtetit, si punojnë partitë politike, komisionerët dhe të komentojë, ose të japë

vlerësime e certifikime të zgjedhjeve. Në këtë kuadër deklaratat, të cilat do t'jua citoj më poshtë, duke bërë një parantezë dhe duke shmangur përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe aspak etike, pasi ne nuk kemi të drejtë të ripërsërisim shprehje që përmbajnë gjuhën e urrejtjes, cenojnë pikërisht këtë lloj kompetence. I referohem ligjit të Policisë së Shtetit, i cili është një institucion i depolitizuar dhe në këtë kuadër askush, madje as Presidenti i Republikës nuk ka të drejtë të shprehet, të japë urdhra, ultimatume dhe t'i kërcënojë punonjësit e Policisë së Shtetit. Mënyra e organizimit dhe funksionimit dhe detyrat konkrete të Policisë së Shtetit në kohën e zgjedhjeve janë të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe njëkohësisht në ligjin organik mbi të cilën organizohet dhe funksionon Policia e Shtetit, për më tepër që Policia e Shtetit është e trajnuar dhe e specializuar për menaxhimin e zgjedhjeve dhe i ka shumë të qarta detyrat e saj falë manualeve dhe trajnimeve të ofruara nga OSBE-ja dhe misionet ndërkombëtare që asistojnë Policinë e Shtetit, por edhe nga kurrikula që ka në Akademinë e Sigurisë. Shprehjet e Presidentit të Republikës, që u bën thirrje dhe i shantazhon punonjësit e Policisë së Shtetit, pra të një force të depolitizuar me kompetenca më se të qarta në ligj, në manuale, në Kodin Zgjedhor, është një shkelje dhe po kaloj të fjala e dytë “shkelje”. Konkretisht më lejoni të theksoj deklaratën e Presidentit të Republikës më 24 prill, që është dita e heshtjes zgjedhore. E para, fakti që deklarata bëhet në ditën e heshtjes zgjedhore është shkelje flagrante e Kodit Zgjedhor dhe fjala kyçe për shkeljet është Kushtetuta dhe ligjet. Në këtë rast konkret veprimtaria e Presidentit të Republikës bie ndesh me formulën e betimit, me nenin 4, ku thuhet që veprimtaria e çdo institucioni bazohet në Kushtetutë dhe në ligje. Ta lëmë ditën kur është bërë deklarata, përmbajtja e deklaratës, dhe ju kërkoj shumë ndjesë që do ta përsëris, fillon me një fjalë politese “Të dashur prokurorë gjyqarë, dëgjojeni mirë Presidentin e Republikës! Boll dëgjuat përfaqësuesit e Ndrangheta-s”. Kush është Ndrangheta? Jemi ne kandidatët për deputetë, janë partitë politike? “Nëse jo, një pikë gjaku të derdhet nesër, por edhe një pikë loti njeriu, mjerë ju!” Çfarë është kjo? Kanosje, është gjuhë që sjell unitetin kombëtar, unitetin e popullit?! E pra kjo shprehje është shumë domethënëse për dy arsye: për ditën kur është shprehur dhe ka dalë publikisht, që është dita e heshtjes zgjedhore, dhe për përmbajtjen e saj.

Njëkohësisht në datën 24 prill Presidenti i Republikës përmend se kriminelët janë kudo të rrezikshëm, edhe unë jam dakord që kriminelët janë kudo të rrezikshëm, në çdo vend, “...por më të rrezikshëm janë kriminelët e veshur me uniformë”, pra sulmon Policinë e Shtetit, që është institucioni bazë për rendin, sigurinë dhe paqen e secilit prej nesh. “...janë ata që gjenden brenda sistemit gjyqësor dhe prokurorisë...”. Më lejoni në këtë rast t'i rikthehem Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe konkretisht nenit 135, që flet për organizimin e pushtetit gjyqësor, si dhe nenit 145/1, që flet për organizimin e prokurorisë. Në nenin 135 të Kushtetutës

së Republikës së Shqipërisë thuhet që pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit, Gjykata e Shkallës Parë dhe gjykatat që krijohen me ligj, nuk thuhet që pushteti gjyqësor dhe drejtësinë e bën Presidentit i Republikës. Gjithashtu në nenin 145, paragrafi i parë, ku flitet për gjyqtarët, thuhet se ata janë të pavarur dhe i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve dhe askush nuk ka të drejtë të bëjë presion, të intimidojë dhe kërcënojë. Nuk thuhet që ata duhet t'i nënshtrohen Presidentit dhe duhet ta dëgjojnë atë, aq më tepër që Presidenti i Republikës nuk është pushtet dhe nuk ka pushtet kontrolli përveç se t'i dekretojë gjyqtarët për Gjykatën e Lartë dhe atë Kushtetuese. Më lejoni të sjell në vëmendje edhe një nen tjetër, nenin 148 të Kushtetutës. Ndjesë që po i lexoj nenet, por mendoj se duhet të flasim me Kushtetutë, pasi flasim për shkelje të rëndë të Kushtetutës! Në nenin 148 të Kushtetutës pika 1 thuhet që prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, ai kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. Njëkohësisht në paragrafin e dytë flitet që prokuroria është një organ i pavarur, që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve të tjerë. Në cilin institucion, në cilin nen të Kushtetutës thuhet që prokurori duhet të dëgjojë Presidentin e Republikës? Ne me reformën në drejtësi kemi bërë një ndryshim thelbësor, prokurorët e veçantë nuk kanë varësi nga Prokurori i Përgjithshëm, prokurorët e posaçëm, në strukturën e SPAK-ut, nuk kanë varësi për përmbajtjen dhe hetimin e çështjes në ushtrimin e funksionit të tyre të ndjekjes nga drejtuesi i prokurorisë së posaçme dhe jo më të dëgjojnë, ose të respektojnë urdhrat dhe udhëzimet e Presidentit të Republikës.

Nga ana tjetër, të nderuar kolegë, si e lexoni thirrjen: “Mjerë ju, do t’ju arrestojë populli në flagrancë! Mos e detyroni popullin t’ju arrestojë!”, thirrje që u bëhet prokurorëve, gjyqtarëve dhe Policisë së Shtetit? “Sfurqet do të jenë të dielën, nëse preken”. Edhe në këtë kuadër, për kë janë sfurqet? Jemi në periudhën e shoqërisë primitive? Jemi në periudhën e një shoqërie, që nuk njeh shtetin e së drejtës, rendin, institucionet, përgjegjësitë dhe kompetencat? Edhe në këtë aspekt sjelljet dhe deklaratat e Presidentit të Republikës kanë cenuar rëndë pavarësinë e institucioneve, konkretisht të sistemit gjyqësor, të prokurorisë dhe i kanë intimiduar ata, duke shkelur në këtë mënyrë betimin, përgjegjësitë dhe kompetencat e Presidentit të Republikës.

Unë do të doja të ndalesha në një aspekt tjetër të rëndësishëm, ligjshmëria dhe kushtetutshmëria e veprimtarisë së Presidentit të Republikës. E them këtë sepse shpesh, Presidenti i Republikës në daljet e tij publike, siç duket, pasi lëshonte deklarata, dikush i tërhiqte vëmendjen ose reagonte, e mblidhte mendjen dhe përpiquej të justifikonte dhe të thoshte se është garant i Kushtetutës. Ai është qytetar që mban përgjegjësi për zgjedhjet. Madje zgjedhjet e 25 prillit janë një referendum. Pra, bënte edhe thirrje të njëanshme për ndryshim të

qeverisjes dhe në shumë deklarata, ndoshta kolegët e tjerë edhe mund t'i analizojnë, ka thirrje për ndryshim të qeverisjes, çka do të thotë se shkel një parim të rëndësishëm të sanksionuar në nenin 89 të Kushtetutës, ku thuhet se Presidenti i Republikës nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër, nuk mund të jetë anëtar partie dhe të kryej veprimtari të tjera private.

Lidhur me ligjshmërinë e veprimtarisë së Presidentit të Republikës, unë do të doja të bazohesha jo vetëm te Kushtetuta, por edhe tek opinionin e Komisionit të Venecias për Shqipërinë në rastin e çështjes që ne përcollëm në Komision të Venecias për mosdekretimin e datës së zgjedhjeve dhe për procedurën e zgjedhjes ose dekretimit të anëtarëve të GJK-së.

Ajo që unë do të doja të evidentoja që në fillim është parimi që Presidenti i Republikës është përfaqësues i unitetit të popullit, pra Presidenti i Republikës në të gjithë veprimtarinë e tij duhet të respektojë nenin 86 të Kushtetutës dhe konkretisht, paragrafin e parë.

Komisioni i Venecias e ka vlerësuar sjelljen e Presidentit të Republikës dhe në një opinion, konkretisht, opinionin 959 të vitit 2019, kur analizon pozitën neutrale që duhet të mbajë Presidenti i Republikës në lidhje me partitë politike, shprehet se ky neutralitet i kryetarit të shtetit duhet të jetë jo vetëm në thelb, në substancë, por edhe në dukje, ai duhet të sillet neutral. Ai duhet të qëndrojë jashtë politikës partiake, me qëllim që t'i shërbejë mes të tjerash, një konkurrence të ndershme midis partive dhe funksionimit të rregullt të qeverisjes.

Presidenti, jo vetëm se ai ose ajo është autoriteti më pushtetshëm, por sepse objektivat që ai duhet të ndjekë, konceptohet se qëndron përtej politikës partiake.

Të nderuar kolegë dhe kolege deputete,

Të gjitha deklaratat e Presidentit të Republikës, që ne i administrojmë në këto letra të shumta që kemi mbi tavolinë dhe që ne i pamë nëpërmjet transmetimit audio dhe video, si dhe provave të vëna në dispozicion nga institucionet përgjegjëse, tregojnë se këto deklarata nuk mbeten jashtë politikës partiake. E para.

E dyta, këto deklarata nuk mundësuan një konkurrim të ndershëm ose Presidenti i Republikës të bënte thirrje për një konkurrim të ndershëm midis partive politike. Padyshim që Presidenti mund t'i thërrasë partitë dhe të bëjë thirrje, mesazhe për të konkurruar ndershëm, për të ulur tonet, për të ulur gjuhën e urrejtjes, nëse në fushata elektorale partitë, liderët përdorin gjuhë urrejtjeje, por kurrsesi nuk mund të jetë përdorues, konsumues i këtyre.

Jo vetëm në thelb, pra në veprimtarinë e tij, por edhe në përmbajtje, në dukje, Presidenti i Republikës nuk është sjellë në mënyrë të paanshme, por është sjellë si pjesë e brendshme e politikës partiake, haptas, në mbështetje të një grupimi partiak, që në rastin e zgjedhjeve të 25 prillit ka qenë opozita.

Përveç kësaj, kur thuhet që Presidenti i Republikës duhet të respektojë ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë, më lejoni të theksoj se parimi i ligjshmërisë, në radhë të parë, është një parim, i cili është në themel jo vetëm të organizimit të institucionit të Presidentit të Republikës, por edhe i funksionimit të këtij institucioni dhe ky parim përmbledh në vetvete kërkesën për ta respektuar Kushtetutën në çdo hap, në çdo veprimtari që kryen Presidenti i Republikës dhe e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit, çka do të thotë se e drejta përbën edhe bazën e veprimtarisë së Presidentit të Republikës.

A ka pasur të drejtë Presidenti i Republikës dhe a është tërhequr nga e drejta në veprimtarinë e tij, për këtë mjafton të shikojmë bazën ligjore. Nuk ka bazë ligjore. Ai ka detyrimin si Presidenti i Republikës të respektojë Kushtetutën dhe kompetencat që i jep Kushtetuta.

Në Kodin Zgjedhor, që unë sapo ju lexova, nuk ka ndonjë kompetencë, nuk ka të drejta as të mbledhë ankesa, as t'i shqyrtojë, as të kërcënojë, as të certifikojë zgjedhjet dhe t'i paragjykojë ato.

Në këtë kuadër, parimi i ligjshmërisë, që është parim kushtetues, është cenuar rëndë në veprimet e Presidenti i Republikës, e para sepse ka shkelur kompetencat (pra, marrim anën formalo-jurike-kushtetuese), kompetencat lëndore nuk i ka respektuar dhe, e dyta, edhe brenda kompetencave që ka të drejtë të ushtrojë ose të veprojë, edhe aty ekziston parimi i shtetit të së drejtës, është parimi “*check and balance*”, pra nuk mund të marrë kompetenca të vlerësojë prokurorinë, gjykatat, Policinë e Shtetit, sepse funksionon parimi i ndarjes së pushteteve dhe në rastin konkret veprimtaria ekzekutive e institucionit të Presidentit të Republikës ka cenuar rëndë parimin e ndarjes së pushteteve, megjithëse ai nuk është pushtet dhe nuk ka të drejtë të hyjë, sepse edhe kur ka cenim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, ka institucione të tjera që e vlerësojnë nëse ka cenim të këtij parimi dhe në ç'shcallë.

Kur flasim për parimin e ligjshmërisë, unë do të doja të eidentoja edhe një aspekt tjetër. Jo vetëm kompetencat që duhen respektuar, por edhe veprimtaria në tërësi, brenda kompetencave, duhet të jetë e ligjshme. Pra, flas për ligjshmërinë edhe formalo-juridike, edhe materialo-juridike.

Parimi i ligjshmërisë dhe sundimi i së drejtës janë parime bazë. Këto janë parime kushtetuese. Në vlerësimin tim, që të dyja parimet janë shkelur dhe kjo shkelje është një shkelje e rëndë.

Thelbi i komisionit është shkelja dhe nëse shkeljet janë shkelje të rënda. Në këtë kuadër, më lejoni të theksoj se ne kemi një opinion të Komisionit të Venecias lidhur me shkeljet dhe shkeljet e rënda. Nuk kemi një jurisprudencë dhe mua më vjen mirë që më së fundi Gjykata



Kushtetuese, për herë të parë, do të krijojë një jurisprudencë lidhur me shkeljet e rënda ose jo të rënda në rastin e veprimeve të Presidentit të Republikës. Pra, çdo aksion, çdo veprim, çdo nismë që merr Kuvendi i Shqipërisë, sovrani, bazuar në Kushtetutë dhe në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore parlamentare” ka një vlerë, sepse ne po kontribuojmë në krijimin e një praktike shumë të rëndësishme, e para, që çdo institucion, duke filluar nga Presidenti i Republikës, duhet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe askush nuk është mbi ligjin, kushdo qoftë ai.

E dyta, për herë të parë, vihet në provë GJK-ja, duke krijuar një praktikë, e cila do të jetë shumë e rëndësishme dhe unë këtë nuk e lidh me Presidentin e Republikës, që është sot në këtë karrige, unë nuk e lidh me emrin e Presidentit të Republikës, por e lidh me institucionin e Presidentit të Republikës, që edhe kur të mos jemi ne në këtë parlament, të ulen të tjerë kolegë dhe kolege, Presidenti i Republikës, institucioni do të jetë dhe Shqipëria do të vijojë të jetë republikë parlamentare. Sot është zoti Meta, nesër është një president ose presidente tjetër, por kushdo që do të jetë në atë pozicion ka detyrimin të respektojë ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë dhe nuk lejohet të shkelë Kushtetutën. Prandaj edhe praktika, jurisprudenca e GJK-së në këtë rast është shumë e rëndësishme dhe unë mezi pres ta ndjek dhe të shikoj vendimin e saj.

Në lidhje me shkeljet e rënda, padyshim që ne do të përgatisim një raport, por do të jetë GJK-ja ajo që, nëse do të vërtetojë fajësinë, do të bëjë shkarkimin e Presidentit të Republikës.

Më lejoni, të nderuar kolegë, të ndalem në një moment të rëndësishëm! Momenti i rëndësishëm në këtë aspekt është fakti që Presidenti i Republikës përpiqet të justifikohet në deklaratat e tij, që shkeljet të cilat bëhen gjatë fushatës zgjedhore etj., janë shkelje që e kanë vënë në tension si një qytetar ose kryeqytetarin e këtij vendi dhe harron që organet e krijuara nga reforma në drejtësi, SPAK-u, nëpërmjet informacionit që na ka vënë në dispozicion, ka sjellë një informacion të detajuar që institucionet e reja të drejtësisë funksionojnë dhe një numër çështjesh po shqyrtohen nga Prokuroria e Posaçme ose janë deleguar, në varësi të juridiksionit dhe kompetencave, në prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm.

Në këtë kuadër, më lejoni t’ju sjell në vëmendje shkresën e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, zotit Kraja, i cili na ka sjellë një informacion lidhur me numrin e procedimeve, çështjet për të cilat është vendosur mosfillim, çështjet që janë në hetim dhe kjo tregon se nuk ke nevojë të kesh një mbrojtës, një sufler tjetër dhe të marrësh kompetencat kushtetuese të një organi të krijuar me ligj në Kushtetutën që funksionin në bazë të një ligji të miratuar nga parlamenti me 3/5-tat. Pra, mekanizmat e kontrollit edhe të institucioneve të drejtësisë janë të

rregulluara, kemi KLGJ, kemi KLP, kemi GJK, pra nuk ka një vakuum institucional dhe ligjor për të hyrë në funksion kryeshtetari, në rastin konkret.

Gjithashtu, edhe kompetencat në lidhje me shkeljet që mund të bëjë Policia e Shtetit apo çdo qytetar, madje edhe partitë politike, janë të mirëpërcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në Kodin Penal.

Unë do të sillja në vëmendjen tuaj, të nderuar kolegë dhe kolege, që ne të gjithë, shumicë dhe pakicë në parlament, por edhe jashtë parlamentit, me opozitën parlamentare, patëm vullnetin për të deleguar të gjitha krimet zgjedhore, madje edhe një pjesë të veprave penale të kapitullit të krimeve që lidhen me zgjedhjet, SPAK-ut, ndonëse jo të gjitha lidhen me korrupsionin aktiv ose pasiv dhe kemi pranuar, do të thosha, tej profesionalizmit dhe integritetit profesional të secilit prej nesh që jemi juristë këtu dhe që kemi një përvojë, do të thosha, modeste, por të paktën 30 vjet, mbi 30 vjet jemi disa që kemi përvojë që t'ia kalojmë SPAK-ut, pikërisht për të dhënë një garanci që një institucion i pavarur, i cili asistohet, përbëhet nga gjyqtarë dhe prokurorë të vetuar, të vlerësuar që i kanë kaluar të gjitha provat e vlerësimit kalimtar në të tria kriteret: pasuri, integritet moral dhe profesionalizëm që t'i trajtonte raste të tilla. madje, edhe kur një qytetar, nxehet e thyen kutinë e votimit, që nuk ka të bëjë as me korrupsionin, as me shantazhimin, por ia dha mendja dhe e theu. Pra, të gjithë mekanizmat për të garantuar, edhe në rast se Kodi Zgjedhor do të cenohej, ia kemi lënë një institucioni dhe një strukturë të posaçme dhe kemi parashikuar dënime tejet të rënda, në raport me shumë dënime të tjera që parashikohen për krime të rënda në Kodin Penal.

Në këtë kuadër, shantazhimi, thirrjet “për t'i prerë duart”, “për t'i arrestuar populli”, pra jo vetë organet, se ju e dini që organet e SPAK-ut kanë mekanizma të kontrollit të brendshëm në rastet e korrupsionit, të shkeljes së ligjit e të tjera, tregojnë që Presidenti i Republikës cenon disa nene të tjera të Kushtetutës dhe uzurpon, ose merr kompetenca të organeve të tjera që lidhen me qeverisjen e sistemit të drejtësisë, në rastin konkret: KLGJ-ja, KLP-ja apo me mekanizmat e brendshëm të kontrollit të këtyre institucioneve.

Unë mund të flas edhe më gjatë, por do të doja ta mbyllja fjalën këtu, dhe do ta mbyll me diçka që besoj se ka mbetur në kujtesën e njerëzve. Më vjen shumë keq që do të mbetet në arkivin e Kuvendit, në arkivin e çdo medie, në arkivin e shtetit ngjarja që ndodhi pikërisht në Elbasan. Po marr ngjarjen e Elbasanit. Presidenti i Republikës gjatë fushatës, sidomos në ditët e fundit e ka ashpërsuar retorikën politike dhe partiake, pra duke lënë neutralitetin në një pozicionim të hapur partiak kundrejt shumë institucioneve, duke goditur edhe institucionet vendore, të vetëqeverisjes vendore, bashkitë, të cilat janë organe që rregullohen, organizohen dhe funksionojnë në bazë të një ligji të posaçëm, njëkohësisht edhe prokuroritë konkrete,

prokurorinë e Elbasanit, duke e konsideruar shtabin kryesor dhe mbrojtësen e Partisë Socialiste ose duke i konsideruar policët si “policët e Mubarakut nën këpucën e populli shqiptar”, shprehje të tilla. Kjo lloj retorike që godet haptazi të gjitha organet Policinë e Shtetit, organet e qeverisjes vendore, qendrore, prokurorinë, gjykatat, duke u ndalur, duke e përshkallëzuar dhe duke kaluar tek institucione konkrete, tek individë konkretë është një gjuhë që nuk sjell as unitet dhe nuk është detyrë e Presidentit të Republikës të vlerësojë sjelljet konkrete, nëse ka cenim të një ligji ose të Kodit Penal. Për më tepër, retorika e përzgjedhur që favorizon dhunën, bën thirrje haptazi në sytë publikut dhe e sheh dhunën si një mjet për zgjidhjen e problemeve kundrejt mjeteve ligjore, kushtetuese që ofron shteti ligjor, shteti i së drejtës, është e rëndë.

“Nëse do të vidhet një votë -, thotë Presidenti-, do të pritët dora në sheshin “Skënderbej”, Kryemadhi e para dhe të tjera”. Kjo thotë se nuk është figurative. Jo, jo do t’i presë ai direkt vetë. Pra, thirrje të tilla për dhunë që kanë shkaktuar një shqetësim te çdo qytetar, te partitë e tjera, janë shprehje shumë të rënda dhe mund të përmbajnë edhe element të veprës penale. Por ne nuk bëjmë dot akuza, nuk ngremë dot akuza penale. Ligji na e ndalon një gjë të tillë, ndoshta institucionet kanë mundësi të hetojnë më tej.

Meqenëse jemi në politikë dhe Presidenti i Republikës, çdo person tjetër, është një funksionar i lartë, më lejoni të përmend 10 rekomandimet për luftën kundër diskriminimit dhe gjuhën e urrejtjes në fushatat zgjedhore të përpunuara nga Rjeti Europian i Organeve të Barazisë (EQUINET). Këto 10 rekomandime, të nderuar kolegë, ju i gjeni në faqet zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe në faqen e Kuvendit të Shqipërisë. Janë 10 parimet që duhet të udhëheqin çdo fushatë elektorale, çdo betejë të kandidatëve, të partive, të liderëve, kur jemi në fushatë. E lidh me 2 fenomene që janë shqetësim dhe kërcënim për rendin dhe sigurinë: diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes që janë motivet ose baza që çojnë në krim të urrejtjes.

E para, në preambulën e këtyre rekomandimeve, 10 rekomandimet e *EQUINET*-it thuhet se, duke iu referuar raportimeve mbi shqetësimin rreth numrit në rritje të fushatave zgjedhore në Europë, të cilat janë të ndotura nga përdorimi i një gjuhe që etiketon fajtorë pa faj dhe diskriminon apo nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes ndaj grupeve të caktuara të shoqërisë, shpesh e justifikuar thjesht si shprehje e mendimeve personale, madje edhe si preokupim për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, këto gjëra për Rrjetin Europian të Organeve të Barazisë janë të ndaluara. Nuk janë të lejuara. Nuk ka asnjë justifikim që unë po shpreh një mendim personal, e para. E dyta, askush nuk mund të thotë se kjo është shprehje e preokupimit për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Do të përmendja dy parime: parimin e ndalimit të diskriminimit dhe parimin e ndalimit të gjuhës së urrejtjes. Besoj se nga e gjithë analiza e deklaratave publike të Presidentit të Republikës në rrjetet sociale, në mediet kombëtare ose në medie të tjera, diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes, madje, në vlerësimin tim si juriste në fushën penale, edhe indiciet për krimet e urrejtjes, janë të pranishme në qëndrimet dhe sjelljet e Presidenti të Republikës.

Faleminderit!

**Alket Hyseni** – Ju falënderoj, zonja Hysi, për ekspozenë e plotë që bëtë!

Do t’ju ftoja të jemi pak më koncizë, për arsye se ka edhe veprimtari të tjera parlamentare, të mos zgjatemi pa fund, pa i marrë të drejtën e fjalës askujt. Mundohuni vetëm të jeni sa më koncizë për të respektuar radhën: një opozitë, një maxhorancë.

Zoti Braho, do t’jua jap më vonë fjalën.

Zoti Stojku.

**Edmond Stojku** – Faleminderit, kryetar!

Sot, pas administrimit të provave dhe fakteve të seancës së kaluar të komisionit hetimor, në diskutimet e kolegëve vihet re një shqetësim, shqetësim, i cili ka shumë kohë që ka ndodhur, pra, për një proces të gjatë të marrëdhënieve të Presidentit me institucionin e Presidencës dhe, njëkohësisht, të Presidentit dhe të institucionit të Presidencës me parlamentin dhe me partitë politike, pra me të gjitha institucionet e tjera, duke futur këtu të gjitha institucionet ligjzbatuese dhe, njëkohësisht, edhe ato të administrimit vendor.

Kemi disa problematika, të cilat në rastin konkret nuk janë thjesht problematika, por janë më tepër precedentë. Bëhet fjalë gjithmonë për një precedent, i cili në historinë 100 e disavjeçare të shtetit shqiptar, nuk e kemi hasur asnjëherë. Ky është një moment krejt specifik i shmangies së një Presidenti nga detyra e tij, i cili është garantimi i Kushtetutës dhe, njëkohësisht, simboli i unitetit të popullit.

Problemi që ka nisur mes Presidentit të Republikës dhe parlamentit shqiptar: të gjithë këtu jemi në dijeni që kemi ulje dhe ngritjet sipas interesit, ndoshta, të Presidentit për njohjen ose mosnjohjen e parlamentit të vitit 2019 e më pas, që do të thotë se këtu kemi një problematikë shumë interesante, e cila është më tepër e vlefshme në aspektin psikik, sepse në aspektin institucional një institucion ose njihet, ose nuk njihet.

Ne kemi rastet kur Presidentit i ka interesuar të njohë vendimet e parlamentit shqiptar dhe kemi rastet po përsëri të këtij parlamenti kur Presidenti nuk i ka njohur vendimet e këtij parlamenti.

Gjithashtu, për atë që jemi mbledhur sot dhe gjithë këto ditë në vijim në komisionin hetimor parlamentar, pra për problematikën e shkarkimit të Presidentit ose jo, do të desha të

theksoj se në aspektin moral Presidenti i Republikës e ka humbur të drejtën për të qenë në këtë rol.

Mjaft që ai vuri veten në bast politik të fitores së maxhorancës si e vetme dhe vetëdeklarimi që, nëse humbet këtë bast, do të deklarohet, unë mendoj se ky president moralisht ka rënë në sytë e publikut. Megjithatë, ne këtu nuk jemi thjesht dhe vetëm për diskutimet politike të një të drejte të fjalës, të një deklarimi të Presidentit ose të personaliteteve të tjera politike, por jemi për rastet e cenimit të ligjit dhe shkeljet e rënda të Presidentit, të cilat mund të çojnë deri në shkarkimin e Presidentit të Republikës. Pikërisht për këtë arsye ne kemi grumbulluar fakte dhe prova që u thanë nga të gjithë kolegët që janë diskutuar në të gjitha seancat e komisioneve hetimore, të cilat janë edhe publike, por janë fakte dhe prova, të cilat i di vetëm komisioni hetimor i ngritur me këtë rast, vetëm kolegët të cilët kanë në rastin konkret certifikatën e sigurisë për të ditur diçka më tepër nga sa di publiku. Në rastet e deklarimeve publike që kemi vënë re Presidenti ka dalë jashtë funksionit dhe jashtë detyrës. Pra, jo vetëm nuk ka mbajtur pozicionin për të unifikuar popullin, por ka cenuar rëndë duke intimiduar personalitete të larta, duke intimiduar institucionet ligjzbatuese, duke intimiduar autoritetet vendore, partitë politike, duke mbajtur gjithmonë vetëm njërin anë dhe duke mos u pozicionuar në pozicionin e tij kushtetues. Pra, në këtë rast ne kemi vënë re një luhajtje, e cila ka qenë pak e çuditshme në grafikun e tij me ngritje dhe ulje, me humorin e zi ose gri të Presidentit, çka nuk ka sjellë asnjë dobi publike në pozicionin në të cilin ai është zgjedhur.

Njëkohësisht, ne kemi shumë pika, në të cilat mund të japim konkluzionet tona, në bazë të administrimit të provave e fakteve. Bëhet fjalë për deklaratimet publike dhe nxitjen e urrejtjes, në njëfarë mënyre deri dhe thirrje për luftë të një pjese të popullatës ndaj një pjese tjetër, e gjithë kjo jo e thënë nga një individ çfarëdo, por nga institucioni i Presidentit të Republikës. Sepse, në fakt, nuk ka qenë vetëm Presidenti personalisht, por ka qenë i gjithë institucioni i angazhuar në këto thirrje publike, me këtë gjuhë urrejtjeje.

Kjo sjell cenimin e rendit e të sigurisë publike, ashtu siç tha edhe kolegja parafolëse. Kemi rastin kur intimidon pikërisht organet e rendit e të sigurisë, duke i konsideruar, duke i krahasuar, duke mos i marrë realisht në konsideratë si mbrojtësit e sigurisë të shtetit e të vendit. Gjithashtu, kemi edhe cenimin moral me partnerët tanë strategjikë, sidomos me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, prononcime të cilat, në fakt, duket sikur janë ndërpersonale mes Presidentit dhe ambasadores Kim, por kjo nuk është e vërtetë, sepse ambasadorja Juri Kim nuk prezanton dhe nuk përfaqëson veten e saj si individ, por përfaqëson Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mendimin e Departamentit të Shtetit, përfaqëson njëkohësisht, si e deleguar, të

gjithë informacionin dhe konkluzionet që ka Departamenti i Shtetit, në bashkëpunim me qeverinë shqiptare, si miku dhe aleati më strategjik i popullit shqiptar.

Gjithashtu, në lidhje me sjelljen e Presidentit, ne kemi kaluar rreth shtatë presidentë, e pothuaj në të gjitha rastet nuk kemi pasur luhatje personaliteti në këto nivele, në këto problematika shëndetësore. Vihet re një luhatje, e cila nuk është normale dhe nuk ka ndodhur asnjëherë, ndonëse kemi raste kur presidentët shpesh kanë qenë kundër maxhorancës, kanë kthyer dekrete, por një sjellje e tillë në vijueshmëri, e paargumentuar, e palogjikshme, duke mos njohur as parlamentin e as Komisionin Hetimor, është një sjellje që lë shumë për të dëshiruar, sipas mendimit tim.

Në rastin konkret, unë dua të kujtoj që, sa herë i ka interesuar Presidentit, e ka njohur diçka. Për shembull, komisionin e parë hetimor që u ngrit për të, e njohu dhe u paraqit aty. U paraqit, prezantoi argumentet, prezantoi problematikat e veta, prezantoi mbrojtjen, në njëfarë mënyre, ndërsa tani, në rastin e dytë, nuk e njeh. Kur parlamenti nuk voton ato që Presidenti ka në mendjen e tij, ai nuk e njeh parlamentin, ndërsa kur parlamenti voton 5 Qershorin, Presidentin e kemi dekretues të menjëhershëm, brenda 24 orëve.

Pra, këtu kemi një shmangie nga detyra, e cila është e ngarkuar me ligj, sepse Presidenti nuk është pushtet i caktuar, siç u tha nga kolegët, por është thjesht moderator mes pushteteve, pra ruan balancën e këtyre pushteteve. Pikërisht për këtë arsye, çdo ndërhyrje e Presidentit politikisht, duke mbajtur një anë, duke bërë thirrje dhe nxitje të gjuhës së urrejtjes para dhe gjatë fushatës elektorale, në ditën e heshtjes zgjedhore, gjë që është e paprecedent, sepse s'e ka bërë asnjë politikan, asnjë nivel i ulët i përfaqësimit politik në historinë e zgjedhjeve pluraliste në Shqipëri, njëkohësisht edhe ditën e zgjedhjeve, unë mendoj se kjo përbën një precedent vërtet të rrallë, vërtet të dënueshëm, mbase një shkelje të rëndë ligjore, e cila mund të çojë deri në shkarkimin e Presidentit të Republikës.

Ne jemi mbledhur këtu që të diskutojmë realisht, teknikisht dhe ligjërisht. Pra, duhet t'ia bëjmë me dije publikut, që ne nuk jemi mbledhur këtu të bëjmë dënimin politik për një të drejtë fjale, por ne duhet të bëjmë krahasimisht raportin mes të drejtës së fjalës së një individi ose të një institucioni të përfaqësuar nga ky individ, me të drejtat ligjore, të cilat ka për detyrë t'i ushtrojë dhe me pasojat që sjell, nëse nuk zbaton ligjin si institucion dhe si individ.

Me pak fjalë, thirrjet, destabilizimi gjithë këto kohë, i njëtrajtshëm i Presidentit të Republikës dhe i institucionit të Presidentit të Republikës, është pikërisht arsyeja e mbledhjes së këtij komisioni hetimor parlamentar, komision i cili, në fund fare do të marrë të drejtën të bëjë një raport paraprak, të bëjë edhe një raport përfundimtar, ku të dalë me konkluzionin që shkeljet e rënda të institucionit të Presidentit të Republikës kanë sjellë këto pasoja, të cilat janë

detyrimisht të dënueshme edhe ligjërisht. Njëkohësisht, do të jemi ne këtu, që do të vendosim për shkarkimin ose jo të Presidentit të Republikës, sepse në fund fare, i gjithë ky komision, gjithë këtë betejë që ne po e bëjmë, po e bëjmë në emër të së drejtës dhe jo në emër të politikës.

Pikërisht për këtë arsye, unë do të doja të thosha se në analizën e bërë gjithë këto kohë, ne shohim realisht një institucion të Presidentit të Republikës të panjohur më parë, të paprecedent, të palogjikshëm, i cili ka sjellë gjithë këtë diskutim, si konkluzion edhe ngritjen e këtij komisioni hetimor. Ky komision hetimor do të marrë vendimet e veta, e më pas do të jetë parlamenti ai që do të vendosë me votë të drejtën e vendimit të Komisionit Hetimor. Pastaj, sipas ligjit, Gjykata Kushtetuese do të vendosë për shkarkimin ose jo të Presidentit të Republikës.

Ju faleminderit!

**Alket Hyseni** – Faleminderit, zoti Stojku!

Zoti Braho.

**Spartak Braho** – Të nderuar kolegë,

Gjatë këtyre dy vjetëve, në mënyrë graduale, demokracia në Shqipëri ka qenë e rrezikuar, dhe ky rrezik i demokracisë lidhet direkt me veprimtarinë antikushtetuese, antiligjore, madje dhe kriminale të Presidentit të Republikës.

Përballë kësaj shtate, me të drejtë Kuvendi i Shqipërisë, si një prej organeve më të rëndësishme të shtetit, vendosi të hetojë veprimtarinë e Presidentit nëpërmjet Komisionit Hetimor, të drejta dhe prerogativa të cilat ia jep vetë Kushtetuta dhe ligji përkatës.

E kam thënë edhe në një mbledhje të mëparshme, se pozicionimi i Presidentit të Republikës duke mos njohur legjitimitetin e Kuvendit të Shqipërisë në përgjithësi dhe të Komisionit Hetimor në veçanti, përbën një qëndrim tejet arbitrar, por edhe me tendencë të lindjes së një mendimi për një puç institucional.

Në vitin 1998, Berisha tentoi të realizonte puç, duke sulmuar institucionet, duke mos i njohur. Këtë gjë ka tentuar edhe Presidentit të Republikës, teksa ka thënë disa herë në korrespondencën me ne, me Kuvendin, por edhe me institucionet e tjera, që ky Kuvend dhe komisioni përkatës nuk kanë legjitimitet.

Pra, ai nuk i njeh. Përpara tij Kuvendi është zero, Komisioni Hetimor është zero, ndonëse formalisht ndërvepron, çon dekrete, miraton dekrete, gjë e cila përbën një falsaturë të hapur, por që përdoret nga ana e tij për nevojat dhe qëllimet që i ka vënë vetes.

Unë nuk do të zgjatem në analizën, që dy koleget tona të nderuara, profesoreshë Hysi dhe Bushka u bënë shkeljeve kushtetuese dhe ligjore të tërë veprimtarisë së Presidentit. Në

mënyrë të detajuar, ne i kemi të rreshtuara, por unë do të theksoja faktin se janë nëntë shkelje të rënda kushtetuese dhe shkelje të ligjit.

Do të veçoja katër prej tyre, jo si më të rëndësishmet, por si më pikantet:

-Shkelja e betimit, që Presidenti i ka bërë Kushtetutës.

-Shkelja e detyrimeve kushtetuese për të qenë përfaqësuesi i unitetit të popullit.

Kjo argumentua shumë qartë. Pra, shkelja e unitetit të popullit, jo siç e thotë ai: jam garant i Kushtetutës. Nuk është ai garant i Kushtetutës. Atë e gënjejnë, është injorant, nuk i kupton, i thotë, s'është faji i tij në këtë rast, por nuk është ai garanti i Kushtetutës. Këtë duhet ta dijë mirë.

-Së treti, ka cenuar rëndë sigurinë dhe rendin kushtetues.

Kjo u argumentua me fakte, me prova.

Së fundi, një shkelje po kaq pikante e po kaq e rëndë është abuzimi dhe shkelja nga ana e tij, në mënyrë direkte e indirekte, me veprime, të kompetencave që ushtron Presidentit të Republikës.

Pse kanë ndodhur këto? Ka shumë faktorë. Nuk do ta lija pa përmendur, se e kemi thënë edhe në një mbledhje tjetër, ka shumë faktorë, ndoshta edhe të gjendjes së tij të rënduar psikologjike, psikik. Mjekët përkatës e analizuan këtu, edhe anëtarë të komisionit, ndaj le të jetë edhe objekt vëzhgimi i Gjykatës Kushtetuese, nëse lypset për të parë statusin e tij psikik, por kryesorja është se në veprimtarinë e tij, Presidenti është udhëhequr nga një filozofi anarkiste, nga një megalomani feudale e një drejtuesi feudal, filozofi e Luigjit XIV, që thoshte: "Shteti jam unë" (*L'état c'est moi*), apo filozofia e Robin Hudit nga Skrapari.

Duke analizuar të dyja këto çështje, unë i bashkohem mendimit dhe përfundimeve të arritura nga dy zonjat e nderuara dhe kolegët e tjerë që Presidenti i Republikës ka shkelur rëndë Kushtetutën. Nuk kemi ne pse të presim me padurim vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese bën vetëm anën formale, se e ka detyrim për t'u shprehur me këtë akt që do të prodhojë Kuvendi. Realisht, në shumë akte të tjera, në shumë vendime të tjera, në të gjithë literaturën shkencore të jurisprudencës vendase dhe të huaj është pothuajse e argumentuar që raste të tilla përbëjnë shkelje të rënda të Gjykatës Kushtetuese. Pse çfarë do të bëjë Gjykata Kushtetuese? A do të bëjë edhe Gjykata Kushtetuese puç, si Presidenti ynë? Ajo do të shprehet dhe ne do të presim të shprehet me objektivitet, duke shuar edhe ata zëra që vënë në dyshim ndershmërinë dhe statusin e pavarur të saj.

Së fundi, ne kemi përpara dhe kemi administruar, të shprehur me shumë kompetencë, ekspertizën shkencore të dy ekspertëve të nderuar kushtetues, të cilët i dëgjuam këtu. Personalisht, nuk i kam njohur më parë, por i vlerësoj në maksimum jo vetëm për erudicionin



e tyre, për nivelin e lartë profesional, por veçanërisht për argumentet që ata parashtruan në ekspertizën që u bënë pyetjeve të drejtuara nga ana e komisionit. A doni t’jua kujtoj përfundimin edhe një herë të ekspertëve që thirrëm?! “Presidenti i Republikës ka shkelur rëndë Kushtetutën”. Ky ishte përfundimi i tyre dhe unë i bashkohem këtij përfundimi.

Faleminderit!

**Alket Hyseni** – Faleminderit, zoti Braho!

Zoti Murrizi apo zoti Jakimi, kush do ta marrë fjalën?

Po, zoti Murrizi, urdhëroni.

**Myslim Murrizi** – Faleminderit kryetar!

Duke u njohur me materialin voluminoz, edhe me mendimin e detajuar të dy ekspertëve të miratuar nga ky komision, edhe me përgjigjet legale, konfidenciale apo të rezervuara të institucioneve, të cilave ky komision iu drejtua me kërkesë, unë do të shpreh shkurtimisht mendimin tim në lidhje me gjithë veprimtarinë e këtij komisioni, qëllimin për të cilin u kërkua ngritja e këtij komisioni dhe mbylljen e hetimeve.

Së pari, jam shumë rehat dhe i qetë që Presidenti i Republikës nuk erdhi në këtë komision që të jem i sinqertë. Ndoshta, duke gërmuar më shumë, mbase do të dilte ndonjë gjë më tepër.

Së dyti, Presidenti i Republikës nuk ka qenë kështu dy vjetët e parë të mandatit të tij, pra nga dita që ju e zgjodhët deri në qershor të 2019-ës. Në këta dy vjet më shumë sesa detajet tekniko-juridike se sa, si dhe ku e ka shkelur apo e ka pickuar Kushtetutën, ajo që më ka bërë përshtypje si qytetar i këtij vendi, si deputet, ka qenë sjellja jodinjitoze në deklaratat publike kundër të një Presidenti të një vendi anëtar të NATO-s prej 13 vjetësh dhe të një vendi që nga dita në ditë pret për t’iu bashkuar familjes dinjitoze të Bashkimit Europian.

Jam përpjekur, shkurtimisht, pa iu kthyer shiritit mbrapsht, të rendis disa ngjarje, të cilat, sinqerisht, më kanë bërë të më shkojnë djersë kur e kam parë në ekranet televizive, por që ju, si maxhorancë, në komisionin e parë nuk e di pse stonuat. Më 2 mars të 2020-ës, ishte hera e parë që Presidenti i një vendi pluralist formalisht nga dhjetori i ’90-ës, fton në protestë qytetarët kundër parlamentit.

Zoti Braho, ndoshta donte ta bënte në ekuivalencë, jo për ta mbrojtur, sepse pikëpamjet e mia dhe ndarjet e mia kanë qenë të hershme me çdo sjellje të kujtdo në këtë vend që nuk ma ka mbushur mendjen dhe nuk ka qenë brenda bindjeve dhe formimit tim, me zotin Berisha. Zoti Berisha në ‘98-ën nuk ka qenë President i Republikës, por ka qenë kryetar i një grushti deputetësh opozitarë, 24 kemi qenë gjithsej në atë kohë, 16 drejtpërdrejt nga zonat, 8 nga lista, pra paskan qenë në të njëjtën staturë. Megjithatë, 2 marsi i 2020-ës: një estradë ku militantë të

porositur ulërinin në kor si gjyqi i deputetëve në '45-ën: “Shpërndaje, shpërndaje, shpërndaje...”, por se çfarë do të shpërndante ky, a farë kosi, a farë jonxhe, nuk e mora vesh?! Ka qenë një akt grotesk i një shtetari që pretendon të jetë, ashtu siç Kushtetuta e sanksionon, kryetar i shtetit shqiptar. Unë ndoshta jam në mendim të kundërt me ju që Presidenti në këtë variant, i zgjedhur sipas pazarit të pistë të prillit të 2008-ës për ndryshimet kushtetuese, përfaqëson unitetin e popullit. Unë them “jo”. Fakti që nuk zgjidhet me shumicë të cilësuar nga Kushtetuta e prillit (të vetmen gjë të mirë në këta 30 vjet të marrjes me politikë të Ilir Metës që unë e ruaj në kujtesën time, grevën e urisë të prillit të 2008-ës për ndryshimet kushtetuese dhe për ardhjen në këtë derexhe që jemi (në atë Kushtetutë janë sanksionuar që në raundin e fundit zgjidhet me 71 vota, që do të thotë me një shumicë të thjeshtë) nuk besoj se e ka mburojën apo petkun për të qenë përfaqësues i unitetit të popullit. Gjithsesi, përtej saj, kam parë disa ngjarje që, edhe po t’i shikoja nga një punonjës, nga 153 mijë që ka administrata e shtetit qendror dhe lokal, nuk do të kënaqesha.

Ngjarja e zyrave të FRD-së! Ai mori përsipër të përzinte policët. Mirë që me FRD-në paska muhabet, por për ne partitë e tjera politike që nuk kemi zyrë, si i bëhet?! A mund ta ftojme të na zërë ndonjë dyqan me zor për ta pasur si zyrë?! “Do të vras veten – tha – si *Salvador Allende* i Kilit”. “Nuk i trembem Amerikës se ka flotë, luftanije, armë bërthamore, se nga këto lloj veglash ka edhe Rusia, ka edhe ai shejtani i Koresë së Veriut”. “Jam gati të vetëflijohem, të shkoj te Mali me Gropa dhe të më gjuajnë me raketë”. Në fakt, shkoi para 4-5 ditësh ambasadorja Kim, demonstroi dhe gjuajtën me armë të rënda e me pistoleta, por pashë tabelë, nuk pashë objektin e ëndërruar apo imagjinar që i jepte të drejtë vetes për të qenë tabelë.

“Do t’u presë duart atyre që vjedhin votat në sheshin “Skënderbej”, një farë sadizmi për fëmijët nën 18 vjeç. Imagjino një farë kasapi me thikë në dorë dhe nuk ndodhi. “Nuk takoj – thotë – më vetëm asnjë ambasador të vendeve të BE-së, se, kur i takoj vetëm, këta dreqër rrejne ose tjetërsojnë”. Një akuzë jo e vogël për një kryetar shteti të një vendi anëtar të NATO-s.

Inspektoi zgjedhjet ditën e diel. A thua se ishte i deleguar nga OSBE- ODIHR-i apo i ngarkuar me punë nga Celibashi, ose mund të ketë qenë në turn si prokuror i gatshëm atë ditë për të bërë arrestime në flagrancë Kjo, në dijeninë time dhe të modeleve të të gjitha vendeve, edhe atyre që vijnë nga ish- kooperativat e variantit si Shqipëria, nuk ka qenë ndonjë precedent i parë, i dëgjuar apo i lexuar në këta 30 vjet postkomunizëm. Shikoj kundërveristet në qëndrimet e tij. Nuk dua të bëj hetuesin, se ne nuk jemi organ hetuesish dhe nuk jemi këtu për të dhënë pretendë. Megjithëse jemi në sallën ku para '90-ës jepeshin pretendat për anëtarët e byrosë politike apo ku di unë kundërshtarët e regjimit diktatorial, ne nuk marrim përsipër kontributet e të qenit prokuror në sallë të gjyqit. Por ndryshe i garantoi të shtunën dhe të dielën

qytetarët shqiptarë, ndryshe e shikoj të dyzuar pas zgjedhjeve. Pra, të dielën tha: “Sa të jem unë këtu, ju rrini rehat se nuk jua prek kush votën”. Të hënën tha: “Vullneti i qytetarëve është në kuti”. Të martën tha: “Na ka vjedhur mafia votën”. Tani mafia nuk e pati frikë këtë?! A e kishte me të shkelur syrin, kështu ishte loja, nuk e pyetën, apo ky doli për të bërë kamuflazh?

Nisur nga të gjitha deklaratat e tij kundraverse, jo pak qesharake për statujën e karriges së shtetit, po flas për deklaratat e tij si President i Republikës, sepse dua ta ndaj sinqerisht zotin Ilir Meta me Presidentin e Republikës, Ilir Meta është në të drejtën e tij për t’u bërë lider i opozitës dhe për t’u rikthyer në politikë. Nuk është rasti i parë në këtë vend, ku pothuajse të gjithë ish-Presidentët e këtij vendi, pa përjashtim, edhe pse në traditën e vendeve Perëndimore, ku vendi ynë ëndërron dhe aspiron të jetë, pasi arrijnë majën, hapin krahun, pasi bëhen President ose janë rikthyer të konkurrojnë për të marrë partinë nga kanë ardhur, ose kanë krijuar parti të tjera për ta filluar përsëri si kryetar grup seksioni, kryeplak, kryetar komune apo kryetar bashkie dhe për t’u rikthyer edhe një herë atje ku ishin. Ky është si sindromë shqiptarësh që buron nga babëzia për pushtet, sepse babëzia e pushtetit të ngroh xhepat dhe të pasuron në mënyrë të padrejtë, sipas asaj që realiteti shqiptar ka parë me sytë e tij në këta 30 vjet postkomunizëm.

Nuk paragjykoj se çfarë do të bëjë Gjykata Kushtetuese, sepse nuk kam të drejtë unë, por besoj edhe kolegët të paragjykojmë vendimin e Kuvendit. Ne nuk dimë dhe nuk kemi pse shprehemi si fakt i kryer se çfarë vendimi do të marrë Kuvendi i Shqipërisë pas raportit përfundimtar të komisionit hetimor. Ndoshta pa dashje edhe unë në medie apo në komision jam shprehur që pas nesh është Gjykata Kushtetuese. Ne jemi aluduar, ndoshta edhe të stigmatizuar nga mediet, sikur e kemi kryer këtë punë. Të presim se me çfarë vendimi, me çfarë raporti do të dalë të premten përfundimisht komisioni hetimor, do të shikojmë se sa dhe si do të silltet me votë Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në të drejtën e tij kushtetuese në lidhje me raportin e komisionit hetimor, se ka pasur praktika 30-vjeçare, ku jo të gjitha raportet e komisioneve hetimore janë miratuar në Kuvend ose kanë dalë me dy raporte shumicë dhe pakicë, por ky është një raport specifik që kërkohet shkarkimi i kreut të shtetit. Pra, të presim dhe pastaj, pasi të ndodhë akti, nëse do të votohet, pra nëse raporti i këtij komisioni të premten mbyllet dhe do të vendosë shkarkimin e Presidentit dhe Kuvendi duhet të jetë në një linjë me mendimin e komisionit, pastaj Gjykata Kushtetuese është në të drejtën e saj për të gjykuar, ashtu siç e ngarkon ligji, vendimin e këtij Kuvendi, nëse është në përputhje me Kushtetutën, apo jo.

Me aq njohuri juridike sa kam, besoj se ky është tagri i Gjykatës Kushtetuese, nuk është se do të na thërrasë si dëshmitarë, apo do të hetojë hetimin tonë, apo do të marrë si të pandehur

subjektin, për të cilin ky komision hetimor, brenda afateve të ngritura nga parlamenti, ka kryer këtë hetim.

Për të mbrojtur dinjitetin e republikës parlamentare, sepse nuk jemi republikë presidenciale apo gjysmë presidenciale, nëse do ta duan kështu baballarët dhe mamallarët e kombit, bujrrëm, t'i drejtohen sovranit dhe ta ndërrojnë Kushtetutën.

Një President që del nga populli, megjithëse nuk janë kompetenca, por këto shkojnë deri në lajthitje, ka pushtet absolut. Ne jemi republikë parlamentare dhe e mirëkuptoj mllëfin shpirtëror, politik të mos begenisjes së këtij komisioni të dytë, në hall e sipër, të Presidentit apo të atyre që e këshillojnë Presidentin.

E fundit, nuk e di se çfarë merak ka, sepse Shqipëria është bërë një model, që, nëse nuk ju pëlqen vendimi i komisionit, apo i parlamentit, apo i Gjykatës Kushtetuese, nëse parlamenti miraton raportin për shkarkimin e Presidentit, rruga është e hapur, le t'i drejtohen ndonjë gjykatë Bashkimit Sovjetik, në Kore, në Kinë apo në Qipro. A ka pak gjykata të tjera?! Por edhe gjykatat e këtyre vendeve, që janë anëtare të OKB-së, nga 209 shtete që ka OKB-ja njëra besoj se do ta marrë në shqyrtim vendimin e Kuvendit apo të Gjykatës Kushtetuese në Shqipëri. Pra, nuk është ndonjë kiamet i madh, nuk ka përse të mërzitet.

Zoti Hyseni, uroj, megjithëse jam skeptik, në vendosmërinë e deputetëve të kësaj legjislature për t'i dhënë dinjitet republikës parlamentare të Shqipërisë me një vendim të drejtë, që të shërbejë si mësim për sa kohë të jetë kjo Kushtetutë dhe ne të jemi republikë parlamentare, që çdo i zgjedhur, edhe me 71 vota, të ushtrojë funksionin dhe detyrën që i ngarkon Kushtetuta, në funksion të atyre pak kompetencave honorifike, do ta quaja unë, që ka Presidenti i Republikës me këtë Kushtetutë që kemi.

Faleminderit!

**Alket Hyseni** – Faleminderit, zoti Murrizi!

Fjalën e ka zoti Jakimi!

**Halil Jakimi** – Përshëndetje, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari, falënderoj sekretariatit e këtij komisioni dhe institucionet e ndryshme të vendit për gjithë materialin e siguruar, i cili ishte shumë i dobishëm për punën tonë!

Gjithashtu, falënderoj edhe ekspertët, që na përgatitën një raport shterues për objektin e hetimit të këtij komisioni!

Përgjatë punës së komisionit kemi dëgjuar deklarata të ndryshme publike, si dhe kemi lexuar materiale me shkrim për gjetjet e shkeljeve kushtetuese të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Unë do të lexoj disa prej tyre, pasi pjesa më e madhe u shterua nga kolegët deputetë, si dhe ana juridike u shterua nga koleget, zonja Hysi dhe zonja Bushka.

Në datën 1.03.2021, në emisionin “Frontline”, në kanal televiziv “News 24”, Presidenti thotë: “Amerikanët e Edi Ramës, Ilir Meta i kap për veshi. Jo, Presidenti, sepse Presidenti është tjetër fuqi, sepse ka fuqinë e popullit shqiptar. E di mirë ai se si u flas unë atyre, kur ata nxijnë dhe bëjnë maskarallëqe për llogari të Edi Ramës”.

Në datën 10.03.2021, në kanal televiziv “Syri TV” Presidenti thotë: “Ky është një ballafaqim mes instalimit të autokracisë dhe kleptomanisë në këtë vend, në shërbim të interesave dhe të tjerëve. Rama është thjeshtë një peng i tyre”.

Në datën 1.04.2021 në kanal televiziv “ABC News” Presidenti thotë: “Ilir Meta nuk pyet për horat dhe gangsterët, nuk pyet për mafien ndërkombëtare dhe as për diplomatët e korruptuar”.

Në datën 10.03.2021 Presidenti thotë: “Shqiptarët janë një popull shqiponjash, që më 25 prill do t’i japin një leksion të fortë demokracie të gjithë atyre që e konsiderojnë popull sorrash dhe delesh”.

“Më 25 prill 2021 do të ketë një referendum mbarëkombëtar për të rrëzuar këtë sistem oligarkësh, që kërkon t’i kthejë qytetarët shqiptarë në qenie të pavlerë, të pafuqishëm dhe të pambrojtur”.

Gjithashtu ka edhe një sërë deklaratash të tjera, që janë bërë para fushatës dhe gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, në datën 24 prill, të cilat për gjykimin dhe mendimin tim kanë qenë deklarata, që kanë nxitur dhunë, konflikt dhe destabilizim apo cenim të rendit kushtetues.

Unë mendoj se Presidenti i Republikës me këto deklarata bie ndesh me Kushtetutën, ligjin dhe formulën e betimit.

Marrja pjesë e Presidentit me një telefonatë në një zyrë partie, zënia e tij me policët bashkiakë të Bashkisë Tiranë dhe fjalori i përdorur i Presidentit është qartë një akt i papranueshëm për demokracinë. Akte të tilla ne i kemi mësuar, unë kam qenë i vogël në atë kohë, në Shqipëri njihet si vit i mbrapsht, në vitin ’97, si pjesë e tij edhe viti ’98, ku dhuna në demokraci nuk duhet të tolerohet.

Mosnjohja e Kuvendit, duke e cilësuar si Kuvend njëpartiak, jolegjitim, jointitucional dhe deputetët e këtij Kuvendi si “dele deputetë”, por edhe me epitete të tjera, kanë bërë që Presidenti i Republikës të kalojë kompetencat e tij edhe në shprehjen tipike dhe atipike.

Intimidimet ndaj punonjësve të policisë, ndaj institucioneve të ndryshme të vendit, si dhe thirrja që u bëri prokurorëve dhe gjyqtarëve që të dëgjonin Presidentin e Republikës dhe jo përfaqësuesin e Ndrangheta-s e të tjera, na japin të drejtën që ky President të mos jetë

përfaqësues i popullit. Ky President ka cenuar rëndë të drejtën kushtetuese në vend, ka nxitur konflikt, ka prishur njëanshmërinë dhe ka anësi në parti politike, pra ka humbur rolin e tij si simbol i unitetit kombëtar.

Refuzimi i mosardhjes në komisionin hetimor mendoj që ka qenë një mbyllje, pasi këto deklarata publike dhe informacione që ne kemi lexuar kanë treguar se janë të pajustificueshme dhe është e vështirë t'i justifikosh këto deklarata, këtë gjuhë dhe ato vendime të marra përpara një komisioni, ku Kuvendi i Shqipërisë sot është në ditën më të mirë që të flasë qartë dhe të mbrojë interesin kombëtar brenda dhe jashtë kufijve të vendit.

Ky President, në gjykimin tim, në provat e mbledhura dhe në gjithçka që kemi mbledhur në këtë kohë, ka shkelur kompetencat e tij, ka ndikuar në balancimin e pushteteve dhe ka cenuar raportet diplomatike dhe të fqinjësisë së mirë që Shqipëria ka me shtetet e tjera. Marrëdhëniet ndërkombëtare ne i kemi të ruajtura prej vitesh dhe figura e Presidentit është kryetar shteti edhe në marrëdhëniet me jashtë.

Në mbyllje të fjalës sime, dua të falënderoj në mënyrë jashtëzakonisht të veçantë çdo qytetar shqiptar, që nuk shkoi pas këtyre deklaratave, edhe pse nuk pati një ndikim të madh publik!

Është detyrë e Kuvendit të shprehet me votë për raportin që ne do t'i dërgojmë seancës dhe qytetarët duhen falënderuar, sepse në datën 25 prill pati një maturi dhe qytetari, pra ishte një ditë e qetë dhe u vendos për vazhdimësinë e demokracisë dhe për të ardhmen e këtij vendi.

Ne si komision kemi punuar dhe do të vazhdojmë të punojmë me seriozitet deri në hartimin dhe përpilimin e raportit përfundimtar dhe mbylljen e punës sonë brenda afateve që na ka ngarkuar Kuvendi i Shqipërisë, ku duhet të shprehim opinionin tonë të mbledhur mbi fakte dhe qëndrime që i kemi mbi tavolinë. Është e papranueshme që ne të mos shprehim atë qëndrim që na ka ngarkuar Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me vendimin për ngritjen e këtij komisioni.

Unë ju falënderoj shumë dhe ju uroj punë të mbarë në ditët në vazhdim, kryetar!

**Alket Hyseni** – Faleminderit, zoti Jakimi!

Meqenëse nuk ka kërkuar dikush tjetër fjalën për diskutime, më lejoni që edhe unë të jap disa qëndrime dhe opinione të miat personale, në cilësinë e një anëtari dhe jo të kryetarit.

Të nderuar kolegë,

Ne e nisëm punën në këtë komision bazuar në vendimin 45 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i cili e ka iniciuar këtë vendim bazuar në kërkesën e 49 deputetëve të këtij Kuvendi, për fillimin e procedurës për shkarkimin e Presidentit të Republikës, për shkak se ata pretendojnë se ka shkelje të rënda të Kushtetutës. Në vijim, vendimi i Kuvendit përcaktoi

ngritjen e këtij komisioni për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, duke i përcaktuar detyrat konkrete.

Së pari, komisioni është ngritur me një përbërje sipas përcaktimeve strikte të ligjit për komisionet hetimore dhe Rregullores së Kuvendit, me një përbërje nga të gjitha grupet parlamentare të këtij Kuvendi, pra nga maxhoranca dhe nga opozita.

Objekti i punës së komisioni është i përcaktuar qartë në vendim dhe është i bazuar qartë në tre shtylla:

Hetimi dhe verifikimi nëse ka akte të kryera apo deklarata nga Presidenti i Republikës në periudhën e përcaktuar në vendim para, gjatë heshtjes zgjedhore dhe gjatë ditës së zgjedhjeve.

Verifikimi i pasojave të ardhura nga këto akte apo këto deklarata në raport me parimin e unitetit të popullit, prishjen e ekuilibrit politik, qetësisë publike, nxitjen e urrejtjes dhe dhunës, vënien në rrezik të jetës së njerëzve, ndërhyrje dhe intimidim në institucione publike, dëmtimin e imazhit të vendit, si dhe marrëdhëniet me partnerët strategjikë të Shqipërisë.

Shtylla e tretë, verifikimi i akteve, sjelljeve dhe qëndrimeve të caktuara të Presidentit.

Janë pikërisht këto akuza të ngritura në kërkesë të deputetëve dhe drejtimet se ku synon puna hetimore e këtij komisioni. Ky komision detyrën për verifikimin e mënyrës së ushtrimit të kompetencave nga Presidenti i Republikës e kryen në përputhje me kuadrin ligjor të Republikës së Shqipërisë. Për t'i realizuar këto objektiva komisioni ka ndërmarrë një sërë veprimesh procedurale në përputhje me përcaktimet e ligjit përkatës, duke miratuar, së pari, rregulloren e funksionimit dhe duke funksionuar mbi bazën e kësaj rregulloreje.

Bazuar në ligjin “Për komisionet hetimore” u hartua kërkesa për një sërë institucionesh, të cilat ishin involvuar, ishin atakuar, ishin intimiduar apo kishin informacion lidhur me objektin e hetimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në Shërbimin Informativ të Shtetit, Gjykatën Kushtetuese, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Policinë e Shtetit.

Gjithashtu, shqyrtoi një tërësi provash, të cilat, në fakt, ishin prova të ditura botërisht, por të administruara në formën zyrtare nëpërmjet AMA-s, Autoritetit të Medies Audiovizive dhe administroi një seri qëndrimesh në rrjetet sociale, në faqen zyrtare të institucionit të Presidentit apo të institucioneve të tjera, të cilat lidhen drejtpërdrejtë ose indirekt me hetimin.

Në përfundim ne administruam një tërësi provash. Në krahun tim të djathtë, por edhe në krahun e majtë, ndodhet tërësia e dokumenteve të administruara, ashtu sikurse çdo deputet në tavolinë ka pikërisht këto prova.

Volumi i këtyre provave dhe gjykimi i secilit prej nesh do të përbëjë shprehjen e vullnetit të çdo anëtari nëse jemi përpara shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i

Republikës. Njëkohësisht, ne kemi kërkuar nëpërmjet disa shkresave informacion nga zyra e Presidentit të Republikës për veprimtarinë e tij, kryesisht në fushën e komunikimit me institucione të ndryshme, edhe për dhënien e titujve dhe dekoratave gjatë kësaj periudhe, por edhe për dhënien e shtetësisë shqiptare gjatë kësaj periudhe. Fatkeqësisht, zyra e Presidentit të Republikës nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për dhënien e informacioneve, i cili buron nga disa ligje, buron nga ligji “Për komisionet hetimore”, buron nga ligji “Për dhënien e informacionit”, buron nga detyrimi i parimit të transparencës së funksionimit të administratës publike, buron nga detyrimi moral i personit nën akuzë për t’i vënë në dispozicion publikut, Kuvendit dhe këtij komisioni të gjithë dokumentacionin e kërkuar.

Përkundër kësaj, Presidenti i Republikës, duke involvuar disa herë edhe kabinetin apo sekretarin e tij të Përgjithshëm nëpërmjet komunikimit me Kuvendin e Shqipërisë ka paraqitur opinionin e tij për mungesën e legjitimitetit të Kuvendit, mungesën e legjitimitetit të këtij komisioni, i cili në varësi të bipolaritetit politik të Presidentit herë është legjitim dhe herë nuk është legjitim. Është legjitim, sipas tyre dhe sipas shkresave të tyre, po jua citoj këtu: “Presidenti shprehet se, nëse do të më kishit thirrur në 10 maj, unë do të vija, por meqë nuk më thirrët në datën 10 maj, nuk jeni legjitim”.

Në fakt, kjo ka qenë një zgjidhje procedurale-taktike për t’i shpëtuar hetimit të këtij komisioni, pasi në rreshtat e mëvonshëm Presidenti shprehet se: “Është legjitime procedura deri në datën 9 dhe pas kësaj date nuk është legjitime”, ashtu sikurse pranon *de facto* që ky komision është legjitim, sepse është ngritur në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin brenda afatit të ushtrimit të veprimtarisë hetimore nga Kuvendi.

Ndryshe nga sa parashtrohet, legjitimiteti i Kuvendit bazohet në Kushtetutë, bazohet në votën që i ka dhënë populli shqiptar, bazohet në aktivitetin dhe ushtrimi i kësaj përgjegjësie konform ligjeve, pavarësisht se është organi që prodhon ligje, ai respekton në mënyrë strikte çdo ligj, ashtu sikurse ky komision respekton në mënyrë strikte çdo ligj.

Mundësia e parashikuar nga Kushtetuta për shkarkimin e Presidentit të Republikës nëpërmjet një procedure strikte të parashikuar jo vetëm në Kushtetutë, në Rregulloren e Kuvendit dhe në ligjin “Për komisionet hetimore” është një shprehje e lartë e demokracisë, është formë demokratike e kontrollit publik mbi veprimet e Presidentit të Republikës, si çdo institucion që buron nga Kushtetuta dhe ligji, është një formë moderne llogaridhënie dhe ushtrimi përgjegjësie para kombit dhe popullit të vet, është një mjet i vetëpërmbytjes së shoqërisë sonë demokratike dhe vetëmbrojtjes së saj nga abuzime të mundshme nga kushdo që merr mandat nga kjo shoqëri nga vota e këtij populli dhe këtu nuk mund t’i shpëtoj dhe nuk mund t’i shmanget as Presidenti i Republikës.



Kuptohet që aktivizimi i këtij mekanizmi do të dëshironim që të ishte sa më i rallë, pse jo të mos ndodhte kurrë, por fatkeqësisht jemi të detyruar ta konsiderojmë faktin që tashmë Presidenti i Republikës së Shqipërisë është kthyer në një recidivist të shkeljeve të Kushtetutës dhe të ligjit dhe fatkeqësisht, ajo që po konstatojmë tashmë, në një shkelës të rëndë të parimeve të kushtetutës, të përcaktimeve të kësaj kushtetute, të kompetencave të ngarkuara nga ajo dhe nga ligje të ndryshme; një person që e ka shndërruar pozicionin e tij në pozicion apo mjet për qëllime personale, politike të vetat dhe të një grupimi të caktuar të ngushtë apo pak më të gjerë, por asnjëherë nuk përfshin tërësinë e popullit e aq më pak të përbëjë disa nga parimet themelore që kanë bërë kushtetutëbërësit, qoftë në Kushtetutën e vitit 1998, qoftë edhe në ndryshimet e mëvonshme që i janë bërë kësaj kushtetute, duke e përcaktuar Presidentin si një figurë shumë të lartë honorifike në pozitën e kryetarit të shtetit, që përfaqëson unitetin e popullit shqiptar.

Ne dëgjuam në këtë komision edhe mendimet e ekspertëve ligjorë të thirrur nga ky komision, të cilët kanë paraqitur dy materiale të shkëlqyera, në gjykimin tim, orientuese për të mundësuar secili nga anëtarët e komisionit një gjykim të drejtë profesional përtej bindjeve politike apo përtej qëndrimeve të ngushta personale.

Çfarë kanë thënë ata? Unë nuk marr përsipër të bëj përmbledhje të raportit, sepse paraqitja nga kolegja Bushka, kolegja Hysi apo edhe nga kolegët e tjerë të nderuar të moxharancës dhe të opozitës si zoti Murrizi, zoti Braho, Jakimi, Çaçani, që paraqitën shumë elemente edhe nga këto raporte të ekspertëve, ka përcaktuar se Presidenti i Republikës në rolin e tij të lartë honorifik duhet të bazohet në disa parime dhe këto jo teorikisht, jo thjesht nga doktrina, jo vetëm nga jurisprudenca, por nga përmbajtja e kushtetutës dhe e ligjeve të këtij vendi, duhet të jetë personi që përfaqëson unitetin jo vetëm në formë, por edhe në përmbajtje, edhe në shprehje, duhet kuptuar që përfaqëson këtë unitet. Këtë gjë e kanë thënë edhe institucione shumë të rëndësishme, të cilave ne u referohemi për marrje mendimi dhe Presidenti i ka konsideruar si busull të veprimtarisë së tij, siç është Komisioni i Venecias.

Fatkeqësisht, në gjykimin tim, për vendin tonë, për shtetin tonë, por edhe për secilin prej nesh Presidenti ka dalë nga këto shina totalisht. Herë-herë ka devijuar, herë-herë ka lundruar në rreshta, por shumë herë ka dalë totalisht nga këto shina, të cilat Kushtetuta i ka përcaktuar pikërisht për të mbajtur atje jo vetë Presidentin, të cilin askush nuk e ka menduar se do të devijonte kaq shumë, por kjo figurë duhet të shërbejë për të mbajtur në shina në kuptimin e një plaku të moçëm, i cili u jep këshilla shumë të matura në vendin e duhur, në kohën e duhur dhe me formën e duhur institucioneve apo personaliteteve të tjera pa ndërhyrë aspak në kompetencat e tyre, duke bërë moderuesin, duke mos mbajtur palë politike e aq më pak të ndërhyjë me qëndrime politike, etiketime deri në fyerje të figurave politike, pavarësisht se dikur

mund të kenë qenë kundërshtarë të tij, ashtu siç kanë qenë aleatë, pavarësisht se mund të mos i pëlqejnë, ashtu sikurse ka shumë që nuk na pëlqejnë ne, por jemi më të lirë për t'u shprehur, sepse ne nuk jemi në cilësinë e detyrës së Presidentit dhe përsëri ruajmë etikën, gjejmë momentin dhe dimë kufijtë tanë se deri ku shkohet.

Ekspertët u shprehën se Kushtetuta ka sanksionuar parimet e përfaqësuesit të unitetit të popullit jo thjesht, e theksova, në rreshta, por në shfaqje dhe shfaqja është e rëndësishme. Fatkeqësisht, pa u zgjatur shumë, vërejtëm se Presidenti i vendit tonë nuk garantoi neutralitetin e institucionit gjatë kësaj periudhe që është objekt hetimi, pa u shtrirë më tej, se mund të shtrihemi edhe më tej në histori, nuk ishte faktor i ekuilibrit të jetës politike, madje edhe sociale të vendit. Këto gjëra të faktuara me këto tërësi CD-ish, aktesh shkresore, por edhe me raporte të institucioneve ndërkombëtare, si për shembull i OSBE-ODIHR-it apo të vëzhguesve vendorë të certifikuar dhe të specializuar për këto çështje.

Deklaratat e tij kanë kaluar në nivelet e qëndrimeve nxitëse jo thjesht politike, por edhe cenuese të rendit, të sigurisë publike dhe deri në konflikte. Deklaratat për veprimet e Presidentit të Republikës kanë qenë tërësisht, në gjykimin tim, në shkelje të kërkesave të parashikuara në nenin kushtetues që përcakton kompetencën e Presidentit, por edhe në nene të tjera që përcaktojnë edhe mënyrën se si ushtrohen këto kompetenca.

Cenimi i imazhit të vendit tonë përtej rolit të tij për të qenë figura që do të përcjellë në mënyrë honorifike qëndrimin e qeverisë dhe të parlamentit dhe ta shfaqë e ta bëjë publike atë atëherë kur është dakord dhe kur nuk është dakord duhet të zgjedhë heshtjen.

Thirrjet për referendum politik dhe personal për një pozicion, i cili, së pari, nuk e ka kompetencën e tagrin, së dyti, nuk buron nga zgjedhja nga populli, por buron nga Kuvendi, të cilin e etiketon “njëpartiak”, “jolegjitim”, “tufë delelesh” dhe të tjera, pa u ndalur në sulmet personale ndaj individëve të caktuar të Kuvendit, deputetë, drejtues grupesh parlamentare, ministra e përfaqësues të tjerë. Thirrjet mjerane për përmbysje, për shfarosje, për korrje nga Jugu në Veri, për shpërndarje të Kuvendit, kur nuk ka asnjë tagër për ta shpërndarë, e kanë nxjerrë totalisht nga shinat dhe jo thjesht si një shkelje Kushtetute, jo thjesht si një kapërcim të lirisë së shprehjes, por si shkelje e rëndë e Kushtetutës së Shqipërisë.

Fatkeqësisht, veprimet e Presidentit për vetëgjyqësi, shpërfytyrimi i individit dhe i institucionit në përlëshje me policët në ushtrim të detyrës së tyre, në ruajtje të një institucioni publik, në ambientet e institucionit publik, si rasti i Bashkisë së Tiranës, thirrjet për vetëgjyqësi të Presidentit të Republikës drejtuar popullit, thirrjet për marrjes sfurqesh, kosoresh, thirrje për të gjetur patronazhistët, duke u thënë patronazhistëve “fshihuni se do t’iu gjejmë”, dhe nuk dua ta lidh me rastin konkret, por, fatkeqësisht thirrje, të tilla dy ditë para, të shoqëruara të

nesërmen me deklarata politike të politikanëve gjaknxehtë të kaheve politike dhe pas dy ditëve shoqërimi me vrasjen fatkeqe të një qytetari, i cili mund të ishte edhe një anëtar partie, që bënte fushatë, por mund të ishte edhe patronazhist, më lënë shije jo thjesht të hidhur, por gjykoj se mund të ketë, përtej shkeljes së rëndë kushtetuese, edhe elementë të veprës penale, për të cilët ne mund t'i shohim në përfundim të debatit nëse do të ketë vetëm një raport për shkelje të rënda, apo mundet t'ia bëjmë me dije Prokurorit të Përgjithshëm për vijimin e një hetimi në drejtim të elementëve penalë të mundshëm në veprimet dhe deklaratimet e Presidentit të Republikës.

Ka shumë njerëz që mendojnë për kompetencat e Presidentit dhe që pyesin: po mirë nuk mund të flasë Presidenti? Patjetër që mund të flasë, Kushtetuta e ka përcaktuar mënyrën si mund të flasë Presidenti i Republikës. Komunikon me mesazhe drejtuar Kuvendit ose drejtuar vendit për situata të rëndësishme, gjithashtu, vepron me ushtrimin e kompetencave, kufijtë i ka të pacaktuar nga parimi i unitetit dhe i ekuilibrit, nga vetëpërmbajtja dhe paanësia, nga respektimi i ligjit dhe Kushtetutës, nga prezantimi si përfaqësues i shtetit shqiptar në raport me qëndrimet e organeve, që e bëjnë politikën e shtetit, e kam fjalën politikën e jashtme. Në këtë aspekt unë mendoj se është tejkaluar çdo limit, duke kaluar në elementë të plotë të shkeljeve të rënda.

Procesi, në fakt, për disa që e kanë shqetësim, nuk është i lidhur fare me një emër individ. Në gjykimin tim, po të ishte vetëm vlerësim politik, mund të mos ia vlen fare të merremi me një individ, i cili nuk ka më parimet e një shtetari dhe, gjithsesi, është në degradim dhe përfundim të mandatit. Por, procesi nuk lidhet as me momentin, as me disa momente sporadike, procesi nuk lidhet ngushtësisht as me një ose disa veprimi, është një proces që lidhet me përgjegjshmërinë dhe detyrimin tonë për të zbatuar Kushtetutën, ligjet, për të ruajtur parimet e Republikës Parlamentare të Shqipërisë, për të ruajtur funksionimin e një shteti, i cili është shtet i së drejtës, ku secili nga institucionet mund të ketë lirinë dhe pavarësinë e tij, aq sa e lejon ligji, por jep llogari dhe mban përgjegjësi herë politike, herë morale, por kur ka elemente dhe përgjegjësi disiplinore për largimin nga funksioni ose dhe ligjore në rast se ka elementë të veprës penale.

Në këtë këndvështrim, iniciativa jonë nuk është kundër Ilir Metës, është kundër një presidenti, i cili shkel Kushtetutën e vendit; iniciativa jonë nuk është për këtë president, është për këdo president ose individ, që do të ketë detyrën e presidentit, që do të ketë një detyrë tjetër të përcaktuar nga Kushtetuta dhe ligji për të kuptuar se kjo detyrë nuk është mundësi abuzimi, por është përgjegjësi e ushtrimit në bazë të ligjit dhe të Kushtetutës.

Unë i bashkohem qëndrimit të të gjithë kolegëve që jemi para përmbushjes së të gjithë elementëve të shkeljeve të rënda të Kushtetutës, jo një, sepse do të mjaftonte dhe secila më vete për të legjitimuar shkarkimin e Presidentit, por tashmë kemi një tërësi shkeljesh të rënda kushtetuese, të cilët na bëjnë ne të vijojmë punën me hartimin e një raporti drejtuar seancës plenare, ku të rekomandojmë shkarkimin e Presidentit të Republikës. Pastaj do të jetë seanca që, pavarësisht qëndrimit të Komisionit, mund të miratojë ose mund të mos e miratojë raportin; mund të marrë vendimin për të shkarkuar Presidentin dhe për t'ia përcjellë Gjykatës Kushtetuese ose jo; mund të sigurojë kuorumin e duhur të votave, pasi kushtetutëbërësi ka garantuar e ky proces të kalojë në nivelet maksimale të votimit, duke kërkuar një shumicë super të cilësuar dhe jo si një të procedurë e zakonshme, aq sa kërkohet për zgjedhjen e Presidentit, por shumë më tepër se kërkohet për zgjedhjen e Presidentit. Nëse një President mund të zgjidhet edhe me 71 vota, për shkarkimin e tij nuk mjaftojnë kaq vota, por kërkon vota përtej një maxhorance dhe në rastin konkret do të kërkojë votat e shumë faktorëve në parlament, votat e maxhorancës dhe të grupeve opozitare.

Le t'ia lëmë seancës plenare këtë qëndrim dhe, nëse seanca do të mbështesë raportin që ne do t'i deklarojmë, më tej është filtri i Gjykatës Kushtetuese, e cila kam bindje e plotë që do ta shqyrtojë me profesionalizëm dhe jo sikurse i kërkon Presidenti i Republikës, për shembull, në një shkresë të datës 5 prill 2021 drejtuar emër për emër anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, precedent i paparë në Shqipëri. Do të citoj disa fjali për publikun, se anëtarët e komisionit janë të njohur, ku është një qëndrim pas një vendimi, sepse para vendimit Presidenti ka të drejtën kur inicion procesin që të paraqesë opinionet, por pas dhënies së vendimit është kjo shkresë. Aty thuhet: “5 anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, që me votat e tyre rrëzuan kërkesën e Kontrollit të Lartë të Shtetit, i kujtoj përmbajtjen e ligjit. Këtyre dispozitave të Kushtetutës sonë i duhej t'i referohej shumica në Gjykatën Kushtetuese për të marrë vendim të drejtë ,gjë të cilën nuk ka mundur ta bëjë. Nga ana tjetër, gjej rastin të falënderoj dy anëtarët e tjerë, të cilët nuk kanë qenë pjesë e kësaj vendimmarrjeje, si dhe shumë vendimmarrjeve të tjera”. Vazhdon duke thënë: “I kërkon Gjykatës Kushtetuese, si instancë e fundit, që t'i përmbahet detyrimit të shkëputet nga influenca e institucioneve dhe të dëgjojë Presidentin”. E plot skandale të kësaj natyre në rreshtat e mëposhtëm, të cilët nuk jam krenar që po i lexoj, por është fakt që ka ndodhur. Si kjo shkresë, ka shkresa drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Policisë së Shtetit, KED-së, por shkresat ndaj KED-së nuk i administruam, sepse janë përtej afatit. Mjafton secila nga këto shkresa më vete, edhe kjo, që Presidenti i Republikës të konsiderohet në shkelje flagrante dhe të rëndë të Kushtetutës për ta larguar nga kjo detyrë, por pa paragjykuar derisa të merret vendim.

Unë falënderoj secilin nga anëtarët për punën e bërë deri tani!

Falënderoj këshilltarët dhe stafin teknik, ekspertët ligjorë, të gjitha institucionet që kanë bashkëpunuar dhe kanë dhënë informacion mjaft të vyer, gjë që do të na bëjë ne të marrim vendim të ftohtë dhe të drejtë, të paanshëm dhe të pandikuar politikisht dhe personalisht!

Me kaq i mbyll diskutimet për çështjen e dytë të rendit të ditës, për debatin rreth administrimit të provave. Proceduralisht na duhet të caktojmë dy relatorë ose disa, por unë mendoj 2; një nga maxhoranca, një nga opozita. Pas konsultimeve që kemi bërë edhe si kryesi, por edhe me ju kolegë, unë propozoj që dy relatorët të jenë: zonja Klotilda Bushka dhe zoti Arlind Çaçani nga opozita, të cilët kanë detyrimin dhe përgjegjësinë, nëse do ta pranojnë dhe do të votohen nga ky komision, që të paraqesin brenda ditës së nesërme një raport paraprak, për ta parë dhe diskutuar nëse është në përputhje me vullnetin e secilit nga ne dhe për të kolauduar brenda kësaj jave, pra aftit të caktuar nga Kuvendi, me miratimin e raportit përfundimtar, që do t'ia paraqesim Kuvendit.

A jeni dakord me emrat? Kundër? Abstenim?

Miratohet caktimi i dy relatorëve me të gjitha votat.

A është e mjaftueshme koha deri nesër në orën 14:00 për të caktuar mbledhjen tjetër të komisionit?

Punë të mbarë!

Do të keni në dispozicion këshilltarët dhe sekretariatën për t'ju ndihmuar për çdo material që doni.

Mbledhja për ditën e nesërme do të njoftohet zyrtarisht, por, pas konsultash që kemi bërë deri tani, do të jetë në orën 14:00.

Ditë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

**Kryetar**  
**Alket Hyseni**

**Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve**  
**Euzheni Pengili**

**Sekretare e komisionit**  
**Evi Naku**